



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I MJEKËSISË

DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE TË BRENDSHME

DISERTACION

PËR MARRJEN E GRADËS

“DOKTOR I SHKENCAVE MJEKËSORE”

TEMA

**BARRA E SËMUNDJES PULMONARE OBSTRUKTIVE
KRONIKE NË SHQIPËRI**


Doktoranti:

Dr. Holta Tafa

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Hasan Hafizi FCCP

Tiranë 2023



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I MJEKËSISË

DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE TË BRENDSHME

DISERTACION

PËR MARRJEN E GRADËS

“DOKTOR I SHKENCAVE MJEKËSORE”

SPECIALITETI: PNEUMOLOGJI

MBROHET ME DATË _____ / _____ /2023 PARA JURISË

- | | |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Prof. Dr. Silvana Bala | KRYETAR |
| 2. Prof. Dr. Jul Bushati | ANËTAR (OPONENT) |
| 3. Prof. Dr. Enver Roshi | ANËTAR (OPONENT) |
| 4. Prof. Dr. Adriana Babameto | ANËTAR |
| 5. Prof. Dr. Gjeorgjina Kuli | ANËTAR |

Tiranë 2023

Falenderim

Falënderoj udhëheqësin shkencor Prof. Dr. Hasan Hafizi FCCP, për ndihmën në të gjitha etapat e studimit, duke më ofruar eksperiencën dhe ekspertizën e tij në fushën e mjekësisë.

Falënderoj gjithë ekipin e BOLD-it në Shqipëri, që kanë kontribuar në realizimin e këtij projekti madhor dhe përkatësisht: Donika Bardhi, Anila Aliko, Natasha Thanasi, Arjan Mezini, Alma Teferiçi, Jolanda Nikolla Rezarta Kazazi dhe Dafina Todri.

Falënderoj familjen time për mbështetjen që më dhanë, për të përfunduar këtë projekt shkencor.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	1
2.Faktorët që Influencojnë Zhvillimin dhe Progresin E Sëmundjes.....	3
3.Patologjia, Patogjeneza.....	6
4.Fizpatologjia	7
5.Diagnoza e SPOK-ut.	10
6.Parandalimi dhe Terapia Mbajtëse	17
2.Teza: Barra e Sëmundjes Pulmonare Obstruktive Kronike në Shqipëri	21
Qëllimi & Arsyeimi	22
Objektivat dhe Qëllimet Përfundimtare	24
Metoda e Studimit.....	25
Vlerësimet dhe Procedurat.....	26
Objektivat Operative.....	28
Procesi i Përkthimit të Pyetësorëve	29
Rekrutimi i Stafit që Punoj në Terren.....	32
Studimi Pilot	33
Përzgjedhja dhe Rekrutimi i Popullsisë së Studimit.....	35
3.Rezultatet	39
4.Diskutimi	61
5.Përfundime	63
6.Rekomandime.....	64
7.Referencat.....	65

HYRJE

Përkufizimi

Sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK-u), është një sëmundje e shpeshtë, e parandalueshme dhe e trajtueshme, që karakterizohet nga simptoma respiratore persistente dhe kufizim të fluksit të ajrit, për shkak të anomalive të rrugëve ajrore dhe/ose alveolave. Zakonisht, këto janë të shkaktuara nga ekspozimi sinjifikant ndaj grimcave ose gazrave të dëmshëm dhe ndikohen nga faktorë individualë, përfshirë zhvillimin anormal të mushkërive. Prania e sëmundjeve bashkëshoqëruese ndikon në sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë nga SPOK-u.⁽¹⁾ SPOK-u është shkak i rëndësishëm i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, në të gjithë botën dhe shkakton një barrë ekonomike dhe sociale të madhe, e cila është në rritje.^(2,3) Prevalenca, sëmundshmëria dhe vdekshmëria nga SPOK-u, ndryshojnë shumë sipas vendeve dhe grupeve të ndryshme brenda vendeve. SPOK-u është rezultat i bashkëveprimit kompleks, të ekspozimit kumulativ afatgjatë ndaj gazrave dhe grimcave të dëmshme, të kombinuara me një sërë faktorësh individualë, duke përfshirë gjenetikën, hiper-reagimin e rrugëve ajrore dhe zhvillimin e prapambetur të mushkërive gjatë fëmijërisë.⁽⁴⁻⁶⁾ Shpesh, prevalenca e SPOK-ut, është e lidhur drejtpërdrejt me prevalencën e pirjes së duhanit. Megjithatë, në shumë vende, ndotja e ajrit të ambientit të jashtëm, atij profesional dhe atij të brendshëm (që rezulton nga djegia e drurit dhe lëndëve djegëse të tjera të biomasës), janë faktorë kryesorë të rrezikut për zhvillimin e SPOK-ut.^(7,8) Përhapja dhe barra e SPOK-ut, janë parashikuar të rriten gjatë dekadave të ardhshme, për shkak të ekspozimit të vazhdueshëm ndaj faktorëve të rrezikut për zhvillimin e tij dhe plakjes së popullsisë së botës. Me rritjen e jetëgjatësisë, më shumë njerëz, do të shprehin efektet afatgjata të ekspozimit ndaj faktorëve të rrezikut për zhvillimin e SPOK-ut.⁽⁹⁾

Prevalenca

Të dhënat ekzistuese të prevalencës së SPOK-ut ndryshojnë shumë, për shkak të ndryshimeve në metodat e studimit, kriteret diagnostike dhe përjasjet analitike.⁽¹⁰⁾

Pavarësisht nga kompleksiteti, po dalin të dhëna, që mundësojnë vlerësime më të sakta të prevalencës së SPOK-ut. Një rishikim sistematik dhe metanalizë, duke përfshirë studime të kryera në 28 vende, midis viteve 1990 dhe 2004,⁽¹¹⁾ nxori të dhëna që prevalenca e SPOK-ut, është dukshëm më e lartë te duhanpirësit dhe ish-duhanpirësit, krahasuar me jo-duhanpirësit; në moshën ≥ 40 vjeç, krahasuar me moshën < 40 vjeç dhe te meshkujt, krahasuar me femrat.

Programi “Barra e Sëmundjes Obstruktive Kronike të Mushkërive” (BOLD), ka përdorur një metodologji të standardizuar, që përfshin pyetësorë dhe spirometri pre-bronkodilator dhe post-bronkodilator, për të vlerësuar prevalencën dhe faktorët e rrezikut të SPOK-ut, në njerëzit e moshës > 40 vjeç, në të gjithë botën. Studimet për prevalencën kanë përfunduar në 29 vende të botës, përfshirë këtu edhe Shqipërinë dhe po vazhdojnë edhe në nëntë të tjera.⁽¹²⁾ BOLD-i raporton funksion më të keq të mushkërive, krahasuar me studimet e mëparshme. Ai raporton prevalencë të SPOK-ut

grada 2 ose më shumë prej 10.1% (SE 4.8) në total. Ajo rezulton 11.8% (SE 7.9) për meshkujt, dhe 8.5% (SE 5.8) për femrat. BOLD-i raporton prevalencë të konsiderueshme të SPOK-ut (3-11%), tek ata që nuk kanë pinë kurrë duhan.⁽¹³⁾ BOLD-i, gjithashtu, shqyrtoi prevalencën e SPOK-ut në Afrikën veriore, atë sub-Sahariane dhe në Arabinë Saudite dhe gjeti rezultate të ngjashme.⁽¹³⁻¹⁵⁾

Projekti Latino-Amerikan për Investigimin e Obstruksionit Pulmonar (PLATINO),⁽¹⁶⁾ ekzaminoi prevalencën e obstruksionit post-bronkodilatator, midis personave > 40 vjeç, në qytetet më të mëdha, nga secili prej pesë vendeve të Amerikës Latine: Brazil, Kili, Meksikë, Uruguaj dhe Venezuela. Në secilin vend, prevalenca e SPOK-ut rritej me rritjen e moshës, me prevalencën më të lartë midis atyre > 60 vjeç. Prevalenca në popullsinë totale, varioje nga një minimum prej 7.8% në Mexico City, Meksikë, deri në një maksimum prej 19.7% në Montevideo, Uruguaj. Në të pesë qytetet, prevalenca ishte dukshëm më e lartë te meshkujt sesa tek femrat. Kjo kontraston me rezultatet nga qytetet Evropiane si Salzburg, Austri.⁽¹⁷⁾

Bazuar në BOLD dhe studimet e tjera të gjera epidemiologjike, vlerësohet se numri i rasteve të SPOK-ut ishte 384 milion në 2010, me një prevalencë globale prej 11.7% [95% Intervali i Konfidencës (CI)]. Ajo varioje nga 8.4% në 15.0%.⁽¹⁸⁾

Vdekshmëria

Globalisht, ka rreth tre milion vdekje në vit.⁽¹⁹⁾ Me rritjen e prevalencës së pirjes së duhanit në vendet në zhvillim, dhe plakjen popullsisë në vendet me të ardhura të larta, prevalenca e SPOK-ut pritet të rritet gjatë 40 viteve të ardhshme dhe deri në vitin 2060, mund të ketë mbi 5.4 milion vdekje në vit nga SPOK-u dhe kushtet e lidhura me të.^(20,21)

Kjo rritje e vdekshmërisë së lidhur me SPOK-un, është e ndikuar kryesisht nga epidemia në rritje e pirjes së duhanit; reduktimi i vdekshmërisë nga shkaqet e tjera të zakonshme të vdekjes (p.sh. sëmundje ishemike e zemrës, sëmundje infektive), plakja e popullsisë së botës, veçanërisht në vendet me të ardhura të larta dhe mungesa e terapive efektive të modifikimit të sëmundjes.

Barra ekonomike

SPOK-u shoqërohet me një barrë të konsiderueshme ekonomike. Në Bashkimin Evropian, kostot totale të drejtpërdrejta të sëmundjeve respiratore, vlerësohen të jenë rreth 6% të buxhetit total vjetor, të kujdesit shëndetësor. SPOK-u llogaritet të zërë 56% (38.6 miliardë Euro) të kostos së sëmundjeve respiratore.⁽²²⁾

FAKTORËT QË INFLUENCOJNË ZHVILLIMIN DHE PROGRESIN E SËMUNDJES

Pavarësisht se, pirja e duhanit është faktori më i studiuar i rrezikut për SPOK-un, ai nuk është faktori i vetëm dhe ka prova të qëndrueshme, nga studimet epidemiologjike, që jo-duhanpirësit mund të zhvillojnë gjithashtu, kufizimin kronik të fluksit të ajrit.⁽¹¹⁾

Megjithëse disa studime longitudinale të SPOK-ut, kanë ndjekur grupe dhe popullata për deri në 20 vjet,⁽⁵⁾ deri më sot, asnjë studim nuk ka monitoruar progresin e sëmundjes gjatë gjithë dekursit së saj, ose të ketë përfshirë periudhat para dhe perinatale, që mund të jenë të rëndësishme për përcaktimin e rrezikut të ardhshëm të individit për zhvillimin e SPOK-ut. Kështu që, kuptimi aktual i faktorëve të rrezikut për sëmundjen e SPOK-ut, në shumë aspekte, është ende i paplotë.

SPOK-u rezulton nga një ndërveprim kompleks midis gjeneve dhe mjedisit. Pirja e duhanit është faktori kryesor i rrezikut mjedisor për SPOK-un. Megjithatë, më pak se 50% e atyre që pinë shumë duhan, zhvillojnë SPOK gjatë jetës së tyre.

Faktorët gjenetikë

Faktori gjenetik i rrezikut, i dokumentuar më së miri, është deficienca herditare e rëndë e alfa-1 antitripsinës (AATD),⁽²³⁾ një frenues madhor cirkulator i serinë proteazave. Megjithëse mungesa e alfa-1 antitripsinës, është e rëndësishme vetëm për një pjesë të vogël të popullsisë së botës, ajo ilustron ndërveprimin midis gjeneve dhe ekspozimeve mjedisore, që predispozojnë një individ ndaj SPOK-ut.

Një rrezik i rëndësishëm familjar, i kufizimit të fluksit të ajrit, është vërejtur te njerëzit që pinë duhan dhe janë vëllezër e motra të pacientëve me SPOK të rëndë,⁽²⁴⁾ duke sugjeruar që gjenetika, së bashku me faktorët e mjedisit, mund të ndikojë në këtë ndjeshmëri.

Mosha dhe seksi

Mosha, shpesh, renditet si një faktor rreziku për zhvillimin e SPOK-ut. Është e paqartë nëse plakja e shëndetshme, si e tillë, çon në SPOK, ose nëse mosha reflekton shumën e ekspozimeve kumulative gjatë gjithë jetës. Plakja e rrugëve ajrore dhe parenkimës, imitojnë disa nga ndryshimet strukturore të lidhura me SPOK-un.⁽²⁵⁾ Në të kaluarën, shumica e studimeve, kanë raportuar që prevalenca dhe vdekshmëria e SPOK-ut, janë më të mëdha te meshkujt sesa te femrat. Por, të dhënat më të fundit nga vendet e zhvilluara, kanë raportuar se prevalenca e SPOK-ut, tashmë është pothuajse e barabartë te meshkujt dhe femrat, duke reflektuar ndoshta ndryshimin e modeleve të pirjes së duhanit.⁽²⁶⁾ Edhe pse e diskutueshme, disa studime kanë sugjeruar që femrat, janë më të ndjeshme ndaj efekteve të tymit të duhanit sesa meshkujt.⁽²⁷⁾ Sasia ekuivalente e cigareve të konsumuara, shkakton sëmundje më të rëndë te femrat

Rritja dhe zhvillimi i mushkërive

Çdo faktor që ndikon në rritjen e mushkërive gjatë shtatzënisë dhe fëmijërisë, ka potencialin për të rritur rrezikun e një individi për të zhvilluar SPOK. Disa studime kanë treguar një lidhje pozitive midis peshës së lindjes dhe FEV₁ në moshën e rritur⁽²⁸⁾ dhe kanë gjetur një efekt të infeksioneve respiratore, të kaluara gjatë fëmijërisë së hershme. Faktorët në jetën e hershme, të quajtur "faktorë të pafavorshëm të fëmijërisë", duket se janë po aq të rëndësishëm sa pirja e shumë të duhanit, në parashikimin e funksionit të mushkërive, gjatë moshës së rritur.⁽²⁹⁾

Ekspozimi ndaj grimcave

Në të gjithë botën, pirja e duhanit është faktori më i rëndësishëm dhe më i shpeshtë i rrezikut për SPOK. Pirësit e cigareve kanë një prevalencë më të lartë të simptomave respiratore dhe anomalive të funksionit pulmonar, një shkallë më të madhe vjetore të rënies së FEV₁ dhe një shkallë më të lartë të vdekshmërisë nga SPOK-u, sesa jo-duhanpirësit.⁽³⁰⁾ Llojet e tjera të duhanit (p.sh. llullë, puro, nargjile)⁽³¹⁾ dhe marihuana,⁽³²⁾ janë gjithashtu faktorë rreziku për SPOK-un. Ekspozimi pasiv ndaj tymit të cigares, i njohur si duhanpirja ambientale (DPA), gjithashtu mund të kontribuojë në simptomat respiratore dhe në zhvillimin e SPOK-ut,⁽³³⁾ nëpërmjet rritjes së ngarkesës totale pulmonare të grimcave dhe gazrave të thithura. Pirja e duhanit gjatë shtatzënisë, mund të paraqesë rrezik për fetusin, duke ndikuar në rritjen dhe zhvillimin intrauterin të mushkërive dhe ndoshta edhe në inkuksionin e sistemit imunitar.⁽³⁴⁾

Ekspozimet në punë, përfshirë pluhurat organikë dhe inorganikë; agjentët kimikë dhe tymrat, janë një faktor rreziku i nënvlerësuar për zhvillimin e SPOK-ut.^(8,35) Një analizë e një sondazhi të gjerë, "National Health and Nutrition Examination Survey III", me bazë në popullatën e SHBA-ve, me pothuajse 10,000 të rritur të moshës 30-75 vjeç, vlerësoi se fraksioni i SPOK-ut, që i atribuohet ekspozimeve në vendin e punës, ishte 19.2% në total dhe 31.1% midis atyre që nuk pinin duhan.⁽³⁶⁾

Druri, bajgat e kafshëve, mbetjet e të korrave dhe qymyri, që digjen zakonisht, në zjarre të hapura ose soba që funksionojnë keq, mund të çojnë në nivele shumë të larta të ndotjes së ajrit të brendshëm.⁽³⁷⁾ Ekzistojnë dëshmi në rritje që, ekspozimi i brendshëm ndaj lëndëve djegëse moderne dhe tradicionale, të përdorura gjatë gatimit, në shumë vende në zhvillim, mund të predispozojë femrat për të zhvilluar SPOK.⁽³⁸⁻⁴¹⁾

Nivelet e larta të ndotjes urbane të ajrit, janë të dëmshme për individët me sëmundje ekzistuese të zemrës ose mushkërive. Roli i ndotjes së ajrit në ambientin e jashtëm, si një faktor rreziku për SPOK-un, është i paqartë, por roli i tij duket të jetë relativisht i vogël tek të rriturit, krahasuar me rolin e pirjes së duhanit.⁽⁹⁾ Analizat "cross-sectional" kanë treguar një lidhje, midis niveleve ambientale të grimcave PM 2.5/10 dhe prevalencës së SPOK-ut.⁽⁴²⁾ Sidoqoftë, ka prova që ndotja e ajrit, ka një ndikim të rëndësishëm, në maturimin dhe zhvillimin e mushkërive.

Statusi socio-ekonomik

Varfëria shoqërohet vazhdimisht, me obstrukcion të fluksit të ajrit⁽⁴³⁾ dhe statusi më i ulët socio-ekonomik, shoqërohet me një rrezik të rritur të zhvillimit të SPOK-ut.⁽⁴⁴⁾

Megjithatë, nuk është e qartë, nëse ky model pasqyron ekspozimet ndaj ndotësve të ajrit të brendshëm dhe të jashtëm, grumbullimit, ushqyerjes së keqe, infeksioneve, apo faktorëve të tjerë që lidhen me statusin e ulët socio-ekonomik.

Astma dhe hiper-reaktiviteti i rrugëve të frymëmarrjes

Astma mund të jetë një faktor rreziku, për zhvillimin e kufizimit kronik të fluksit së ajrit dhe SPOK-ut. Adultët me astmë, u zbuluan se kishin një rrezik 12 herë më të lartë për të zhvilluar SPOK me kalimin e kohës, krahasuar me ata pa astmë, pas korrigjimit lidhur me pirjen e duhanit.⁽⁴⁵⁾ Rreth 20% e subjekteve me astmë, zhvilluan kufizim të pakthyeshem të fluksit të ajrit dhe reduktim të koeficientit të transferimit.⁽⁴⁶⁾

Sipas European Community Respiratory Health Survey, hiper-reaktiviteti i rrugëve ajrore, është i dyti pas pirjes së duhanit, si faktori kryesor i rrezikut për SPOK-un. Ai është përgjegjës për 15% të rrezikut të atribuar në popullatë (pirja e duhanit kishte një rrezik të atribueshem prej 39% në popullatë).⁽⁴⁷⁾ Patologjia e kufizimit kronik të fluksit të ajrit në jo-duhanpirësit astmatikë dhe duhanpirësit jo-astmatikë, është dukshëm e ndryshme, duke sugjeruar që dy entitetet e sëmundjes, mund të qëndrojnë të ndryshme, edhe kur paraqiten me funksion pulmonar të reduktuar në mënyrë të ngjashme.^(48, 49) Sidoqoftë, dallimi i astmës nga SPOK-u, tek të rriturit, shpesh mund të jetë i vështirë.

Hiper-reaktiviteti i rrugëve ajrore, mund të ekzistojë pa një diagnozë klinike të astmës dhe është treguar të jetë një parashikues i pavarur i SPOK-ut dhe mortalitetit respirator, në studimet e popullsisë, si dhe një indikator i rrezikut të rënies së tejshtuar të funksionit pulmonar, në pacientët me SPOK të lehtë.^(50, 51)

Bronkiti kronik

Fletcher dhe kolegët e tij, në studimet e tyre mbi bronkitin kronik, kanë konstatuar se prania e këtij të fundit, nuk u shoqërua me një rënie të përshpejtuar të funksionit pulmonar.⁽⁵²⁾ Sidoqoftë, studimet pasuese kanë vërejtur një lidhje midis hiper sekretimit të mukusit dhe rënies së shtuar të FEV₁.⁽⁵³⁾ Nga këto studime është vërejtur se, edhe tek të rriturit e rinj që pinë duhan, prania e bronkitit kronik është shoqëruar me një mundësi të rritur, të shfaqjes së SPOK-ut.⁽⁵⁴⁾ Bronkiti kronik është shoqëruar, gjithashtu, me një rrezik të rritur për numrin e përgjithshëm, si dhe gravitetin e acarimeve.⁽⁵⁴⁾

Infeksionet

Një histori e infeksioneve të rënda respiratore të kaluara në fëmijëri, është e lidhur me reduktimin e funksionit pulmonar dhe shtimin e simptomave respiratore, në moshën e rritur. Ndjeshmëria ndaj infeksioneve, luan një rol në acarimet e SPOK-ut, por efekti në zhvillimin e sëmundjes, është më pak i qartë. Në një studim të madh observacional, kolonizimi me *Pseudomonas aeruginosa*, parashikoi në mënyrë të pavarur, një rrezik të shtuar të hospitalizimit gjatë acarimit të SPOK-ut dhe vdekshmërisë nga të gjitha shkaqet.⁽⁵⁵⁾ Ka dëshmi se pacientët me HIV, janë në rrezik të rritur për zhvillimin e

SPOK-ut, krahasuar me kontrollet HIV negativ (11 studime; pooled odds ratio për 1.14 (95% CI 1.05,1.25).⁽⁵⁶⁾ Tuberkulozi është identifikuar, gjithashtu, si një faktor rreziku për zhvillimin e SPOK-ut.⁽⁵⁷⁾ Përveç kësaj, tuberkulozi është njëkohësisht, edhe diagnozë diferenciale e SPOK-ut, edhe një komorbiditet i mundshëm.^(58, 59)

PATOLOGJIA DHE PATOGJENEZA E SPOK-UT

Inhalimi e tymit të cigares, ose grimcave të tjera të dëmshme, siç është tymi nga lëndët djegëse të biomasës, shkakton inflamacion të mushkërive. Inflamacioni i mushkërive është një përgjigje normale, që duket se modifikohet në pacientët, që zhvillojnë SPOK. Kjo përgjigje inflamatore kronike, mund të shkaktojë destruksion të indit parenkimal (duke rezultuar në emfizemë) dhe prishjen e mekanizmave normale të riparimit dhe mbrojtjes (që rezulton në fibrozë të rrugëve të vogla ajrore). Këto ndryshime patologjike çojnë në “air trapping” dhe kufizim progresiv të fluksit të ajrit.

Patologjia

Ndryshimet patologjike karakteristike të SPOK-ut, prekin rrugët ajrore, parenkimën dhe vaskulaturën pulmonare.⁽⁶⁰⁾ Ndryshimet patologjike, të vëzhguara në SPOK, përfshijnë: inflamacion kronik, me numër të rritur të llojeve specifike të qelizave inflamatore, në pjesë të ndryshme të mushkërive dhe ndryshime strukturore, që rezultojnë nga përsëritja e proceseve të dëmtimit dhe riparimit. Në përgjithësi, ndryshimet inflamatore dhe strukturore në rrugët ajrore, shtohen me rritjen e gravitetit të sëmundjes dhe vazhdojnë edhe pas ndërprerjes së pirjes së duhanit. Shumica e të dhënave të patologjisë, vijnë nga studimet te duhanpirësit dhe nuk mund të supozohet, domosdoshmërisht, i njëjti raport midis sëmundjes së rrugëve ajrore dhe asaj parenkimale, kur janë aktivë faktorë të tjerë. Inflamacioni sistematik mund të jetë i pranishëm dhe mund të luajë një rol në komorbiditetet e gjetura, në pacientët me SPOK.⁽⁶¹⁾

Patogjeneza

Inflamacioni i vërejtur në traktin respirator të pacientëve me SPOK, duket se është një modifikim i përgjigjes normale inflamatore të tij, ndaj irritantëve kronikë, siç është tymi i cigares. Mekanizmat për këtë inflamacion të amplifikuar, ende nuk janë kuptuar, por shumë prej tyre, të paktën pjesërisht, janë të determinuara gjenetiksht.

Stresi oksidativ. Stresi oksidativ mund të jetë një mekanizëm i rëndësishëm amplifikues, në SPOK.⁽⁶²⁾ Biomarkuesit e stresit oksidativ (p.sh. peroksidi i hidrogjenit, 8-izoprostani), janë në nivele të rritura në kondensatin respirator të ekspiruar, sputum dhe qarkullimin sistematik, të pacientëve me SPOK. Stresi oksidativ, rritet edhe më tej gjatë acarimeve. Oksidantët gjenerohen si nga tymi i cigareve, ashtu edhe nga grimca të tjera të thithura dhe çlirohen nga qelizat inflamatore të aktivizuara, si makrofagët dhe neutrofilet. Mund të ketë, gjithashtu, një reduktim të antioksidantëve endogjenë, në pacientët me SPOK, si rezultat i reduktimit të nivelit të faktorit të transkriptimit Nrf2, që rregullon shumë gjene antioksiduese.⁽⁶³⁾

Mosbalancimi i proteazë-antiproteazës. Ka prova bindëse për një disbalancë në mushkëritë e pacientëve me SPOK, midis proteazave, që zbërthejnë përbërësit e indit lidhor dhe antiproteazave, që kundërshtojnë këtë veprim.⁽⁶⁴⁾ Në pacientët me SPOK, janë vërejtur nivele të rritura të disa proteazave, që rrjedhin nga qelizat inflamatore dhe qelizat epiteliiale. Ka gjithnjë e më shumë dëshmi, se këto proteaza mund të ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Shkatërrimi i ndërmjetësuar nga proteazat i elastinës, një përbërës kryesor i indit lidhor në parenkimën e mushkërive, besohet të jetë një tipar i rëndësishëm i emfizemës, por mund të jetë më i vështirë për t'u determinuar si rol në ndryshimet e rrugëve ajrore.⁽⁶⁴⁾

Qelizat inflamatore. SPOK-u karakterizohet nga rritja e numrit të makrofagëve në rrugët ajrore periferike, parenkimë dhe vazat pulmonare, së bashku me rritjen e neutrofileve dhe limfociteve të aktivizuara, që përfshijnë qelizat Tc1, Th1, Th17 dhe ILC3. Në disa pacientë, mund të ketë edhe rritje të eozinofileve, qelizave Th2, ose ILC2. Të gjitha këto qeliza inflamatore, së bashku me qelizat epiteliiale dhe qelizat e tjera strukturore, çlirojnë mediatorë të shumtë të inflamacionit.⁽⁶⁵⁾

Mediatorët inflamatorë. Mediatorët inflamatorë, me shumëllojshmëri të gjerë, tashmë e demonstruar të jenë të rritura në pacientët me SPOK-ut, tërheqin qelizat inflamatore nga qarkullimi (faktorë kimotaktikë), amplifikojnë procesin inflamator (citokinat proinflamatore) dhe nxisin ndryshime strukturore (faktorët e rritjes).

Fibroza peribronkiolare dhe intersticiiale. Në pacientët me SPOK, ose tek ata që janë duhanpirës asimptomatikë, janë raportuar fibroza peribronkiolare dhe opacitete intersticiiale.⁽⁶⁶⁾ Te duhanpirësit, ose tek ata me inflamacion para-ardhës të rrugëve ajrore, që kanë edhe SPOK, mund të gjendet një prodhim i tepërt i faktorëve të rritjes. Inflamacioni mund të paraprijë zhvillimin e fibrozës, ose vetë dëmtimi i përsëritur i murit të rrugëve ajrore, mund të çojë në prodhim të tepërt të indit muskolor dhe atij fibrotik. Ky mund të jetë një faktor kontribues, në zhvillimin e limitimit të rrugëve të vogla ajrore dhe eventualisht, edhe të obliterimit, që mund t'i paraprijë zhvillimit të emfizemës.⁽⁶⁷⁾

Dallimet në inflamacion, midis SPOK-ut dhe Astmës. Megjithëse SPOK-u dhe Astma, shoqërohen me inflamacion kronik të traktit respirator, ka dallime në qelizat inflamatore dhe mediatorët e përfshirë në secilën sëmundje.⁽⁶⁸⁾ Disa pacientë me SPOK, kanë një model inflamator me rritje të eozinofileve.⁽⁶⁹⁾

FIZPATOLOGJIA

Tashmë ekziston një kuptim i mirë, se si procesi i sëmundjes në SPOK, çon në anomalitë fizpatologjike karakteristike dhe simptomat specifike. Për shembull, inflamacioni dhe ngushtimi i rrugëve ajrore periferike, çon në uljen e FEV₁.⁽⁷⁰⁾ Shkatërrimi i parenkimës për shkak të emfizemës, kontribuon, gjithashtu, në kufizimin e fluksit të ajrit dhe çon në reduktimin e transferimit të gazit. Ekzistojnë, gjithashtu, prova të reja që sugjerojnë se, përveç ngushtimit të rrugëve ajrore, ka edhe reduktim të rrugëve të vogla ajrore, i cili mund të kontribuojë edhe më tej, në kufizimin e fluksit të ajrit.⁽⁷¹⁾

Kufizimi i fluksit të ajrit dhe retensioni i tij në mushkëri. Shkalla e përhapjes së inflamacionit, fibrozës dhe eksudatit luminal në rrugët e vogla ajrore, korrelohet me

reduktimin e FEV₁ dhe raportit FEV₁/FVC dhe ndoshta, edhe me rënien e përsheptuar të FEV₁, që është karakteristikë e SPOK-ut. Ky reduktim i rrugëve ajrore periferike, pengon në mënyrë progresive nxjerrjen e ajrit gjatë ekspirimit, duke rezultuar në hiperinflacion. Hiperinflacioni statik zvogëlon kapacitetin inspirator dhe zakonisht shoqërohet me hiperinflacion dinamik gjatë efortit, duke çuar në rritjen e dispnesë dhe kufizimin e kapacitetit për të kryer aktivitet fizik. Këta faktorë kontribuojnë në dëmtimin e vetive intrinseke kontraktuese të muskujve respiratorë. Mendohet se hiperinflacioni zhvillohet herët gjatë sëmundjes dhe është mekanizmi kryesor i dispnesë gjatë efortit.⁽⁷²⁾

Anomalitë e shkëmbimit të gazeve. Anomalitë e shkëmbimit të gazeve rezultojnë në hipoksemi dhe hiperkapni dhe kanë në bazë disa mekanizma në SPOK. Transferimi i O₂ dhe CO₂, në përgjithësi përkeqësohet me progredimin e sëmundjes. Ventilimi i reduktuar mund të rezultojë gjithashtu për shkak të reduktimit të nxitjes centrale ventilatore, ose rritjes së ventilimit të hapsirës së vdekur ajrore.⁽⁷³⁾ Kjo mund të çojë në retensionin e CO₂, kur kombinohet me reduktim të ventilimit. Kjo si pasojë e përpjekjes së shtuar për të marrë frymë, për shkak të limitimit dhe hiperinflacionit të rëndë, e kombinuar kjo edhe me dëmtimin e muskujve ventilatorë. Anomalitë në ventilimin alveolar dhe një shtrat i reduktuar vaskular pulmonar, përkeqësojnë më tej anomalitë e V_A/Q (raporti ventilim/perfuzion).⁽⁷⁴⁾

Hipersekretimi i mukusit. Hipersekretimi i mukusit, që rezulton në kollë kronike produktive, është një tipar i bronkitit kronik dhe nuk shoqërohet domosdoshmërisht, me kufizim të fluksit ajrit. Në të kundërt, jo të gjithë pacientët me SPOK, kanë hipersekretim simptomatik të mukusit. Kur është i pranishëm, hipersekretimi i mukusit vjen si pasojë e rritjes së numrit të qelizave “goblet” dhe zmadhimit të gjëndrave submukozale, të cilat rezultojnë për shkak të irritimit kronik të rrugëve ajrore, nga tymi i cigares dhe agjentëve të tjerë të dëmshëm. Mediatorë dhe proteaza të ndryshme, stimulojnë hipersekretimin e mukusit dhe shumë prej tyre, ushtrojnë efektet e tyre, përmes aktivizimit të receptorit të faktorit të rritjes epidermale (EGFR).⁽⁷⁵⁾

Hipertensioni pulmonar. Hipertensioni pulmonar mund të zhvillohet vonë në rrjedhën e SPOK-ut dhe rezulton kryesisht për shkak të vazokonstriksionit hipoksik të arterieve të vogla pulmonare, duke rezultuar eventualisht në ndryshime strukturore, që përfshijnë hiperplazi të intimit dhe hipertrofi/hiperplazi të muskujve të lëmuar më vonë.⁽⁷⁶⁾ Edhe në pacientët me SPOK të lehtë, apo në duhanpirësit e prirur për emfizemë, ka anomali të konsiderueshme të qarkullimit në shtratin mikrovaskular pulmonar, që përkeqësohen me progresionin e sëmundjes.⁽⁷⁷⁾

Në SPOK vërehet gjithashtu, një përgjigje inflamatore në vazat e gjakut, e ngjashme me atë që shihet në rrugët ajrore, së bashku me evidencën e mosfunksionimit të qelizave endoteliale. Humbja e shtratit kapilar pulmonar në emfizemë, mund të kontribuojë më tej në rritjen e presionit në qarkullimin pulmonar. Hipertensioni pulmonar progresiv, mund të çojë në hipertrofi të ventrikulit të djathtë dhe eventualisht, në insuficiencë kardiake të djathtë. Është interesant fakti që, diametri i arteries pulmonare, i matur në skanimet e tomografisë kompjuterike (CT), korrelohet me rrezikun e acarimeve, pavarësisht nga historia e mëparshme e tyre.⁽⁷⁸⁾ Kjo sugjeron që alterimet në vaskulaturën pulmonare janë të mëdha, por jo të njohura plotësisht. Ato janë nxitëse të simptomave dhe acarimeve në SPOK.

Acarimet. Acarimet e simptomave respiratore, të nxitura nga: infeksionet respiratore bakteriale, ose virale (të cilat mund të bashkë-ekzistojnë), nga ndotës të mjedisit, ose faktorë të panjohur, ndodhin shpesh te pacientët me SPOK. Gjatë episodeve të infeksionit bakterial ose viral, ndodh një përgjigje karakteristike, me inflamacion të shtuar. Gjatë acarimeve, ndodh hiperinflacion i shtuar dhe retension i ajrit në mushkëri, me pasojë reduktim të fluksit ekspirator dhe shtim të dispnesë.⁽⁷⁹⁾ Këtyre u shtohet edhe përkeqësimi i anomalive të V_A/Q , që mund të rezultojë në hipoksemi.⁽⁸⁰⁾ Gjatë acarimeve, ka dëshmi të rritjes së inflamacionit në rrugët ajrore. Patologji të tjera (pneumonia, tromboembolia dhe insuficienca kardiake akute), mund të imitojnë ose rëndojnë një acarim të SPOK-ut.

Karakteristikat sistemike. Shumica e pacientëve me SPOK, kanë sëmundje kronike shoqëruese, të lidhura me të njëjtët faktorë rreziku, si p.sh., pirja e duhanit, plakja dhe pasiviteti, të cilat mund të kenë një ndikim të madh në statusin shëndetësor dhe mbijetesën.⁽⁸¹⁾ Kufizimi i fluksit të ajrit dhe veçanërisht hiperinflacioni, ndikojnë në funksionin kardial dhe shkëmbimin e gazeve.⁽⁸²⁾ Mediatorët inflamatorë në qarkullim, mund të kontribuojnë në reduktimin e masës së muskujve të skeletit dhe kaheksinë, dhe mund të iniciojnë, ose përkeqësojnë komorbiditete të tilla si: sëmundjen ishemike të zemrës, insuficiencën kardiake, osteoporozën, aneminë normocitike, diabetin dhe sindromën metabolike.^(83,84)

DIAGNOZA E SPOK-ut

Tiparet Klinike të SPOK-ut

Një histori e hollësishme mjekësore e një pacienti i cili dihet, ose dyshohet të ketë SPOK, duhet të përfshijë:

- Ekspozimi i pacientit ndaj faktorëve të rrezikut, të tilla si: pirja e duhanit dhe ekspozimet në punë, ose mjedis.
- Historia e kaluar mjekësore, përfshirë: astmën, alergjitë, sinusitin ose polipet nazale; infeksionet respiratore në fëmijëri; sëmundje të tjera kronike respiratore dhe jo-respiratore.
- Histori familjare e SPOK-ut, ose e ndonjë sëmundjeje tjetër kronike respiratore.
- Modeli i zhvillimit të simptomave: SPOK-u zakonisht zhvillohet në moshën e rritur dhe shumica e pacientëve nuk janë të vetëdijshëm për shtimin e dispnesë. "Ftohjet e dimrit" më të shpeshta, ose më të zgjatura; disa kufizime shoqërore, për disa vite përpara se të kërkojnë ndihmë mjekësore, duhet të nxisin dyshimin për SPOK.
- Histori e përkeqësimeve, ose shtrimeve të mëparshme në spital, për çrregullime respiratore.
- Prania e sëmundjeve shoqëruese, të tilla si sëmundjet e zemrës, osteoporoza, çrregullimet muskulo-skeletike dhe malinjitetet, që mund të kontribuojnë gjithashtu, në kufizimin e aktivitetit.
- Ndikimi i sëmundjes në jetën e pacientit, duke përfshirë kufizimin e aktivitetit, punën e humbur dhe ndikimin ekonomik, ndjenjat e depresionit ose ankthit, mirëqenien dhe aktivitetin seksual.
- Mbështetja sociale dhe familjare, në dispozicion të pacientit.
- Mundësitë për zvogëlimin e faktorëve të rrezikut, veçanërisht ndalimin e pirjes së duhanit.

Kolla është simptoma më e shpeshtë, e raportuar nga pacientët me SPOK. Kolla paraprind shfaqjen e dispnesë, ose ndodh në të njëjtën kohë me të, në shumicën e pacientëve. Shumica e pacientëve me SPOK, shfaqin kollë, shtim të sputumit dhe dispne, por zakonisht është dispnea ajo që i bën ata të kërkojnë kujdes mjekësor. Kolla mund të jetë shumë shqetësuese, por në shumicën e rasteve, zakonisht, nuk ndërhyr në aktivitetet e përditshme dhe shpesh pacienti, nuk është i ndërgjegjshëm për shpeshtësinë e saj. Një kollë produktive nuk duhet të suprimohet dhe një kollë kronike, që shfaqet çdo ditë, parashikon acarime të shpeshta.⁽⁸⁵⁾

Prodhimi i sputumit është i fshehtë në fillimin e tij dhe në shumicën e pacientëve është "i pakët", i përcaktuar si më pak se disa lugë gjelle, në ditë. Prodhimi i sputumit lidhet, gjithashtu, me statusin e pirjes së duhanit. Pirësit e duhanit, kanë shumë më tepër sputum. Ky i fundit, zakonisht është mukoid, por bëhet purulent gjatë episodeve infektive dhe mund të duhen 2 deri në 3 javë për t'u pastruar. Pas ndërprerjes së pirjes së duhanit, sputumi mund të bëhet përkohësisht më i vështirë për t'u ekspektoruar, për shkak të zvogëlimit të aftësisë pastruese të kollës, por simptomat përgjithësisht zvogëlohen pas ndërprerjes së pirjes së duhanit.⁽⁸⁶⁾

Dispnea, sidomos në effort, është zakonisht simptoma prezantuese dhe me progredimin e sëmundjes, ndodh në eforte gjithmonë e më minimale. Dispnea në pacientët me SPOK,

ka të ngjarë të rezultojë nga hiperinflacioni dinamik, i cili përkeqësohet me rritjen e frekuencës respiratore. Si rezultat, shumë pacientë shmangin dispnenë, duke shmangur efortin dhe mund të bëhen sedentarë.⁽⁸⁷⁾

Ekzaminimi Fizik

Në shumë pacientë me SPOK, ekzaminimi fizik zbulon anomali të pakta, sidomos gjatë frymëmarrjes së qetë. Krepitancat e ashpra, që ndodhin herët në inspirim, janë lidhur me sëmundjen obstruktive të mushkërive, megjithëse mund të jenë të pranishme edhe zhurma të tjera shtesë adventiciale. Ronchi janë më prevalent në pacientët që ankohen për dispne dhe zakonisht janë të pranishme si gjatë inspirimit ashtu edhe ekspirimit. Wheezing nuk është gjetje konstante dhe nuk korrelohet me gravitetin e obstruksionit. Gjetja më konsistente në pacientët simptomatikë me SPOK, është zgjatja e fazës ekspiratore, e cila përcaktohet më së miri, duke dëgjuar mbi laring, gjatë një manovre të sforcuar ekspiratore. Zgjatja e fazës ekspiratore më shumë se 4 sekondat normale, është tregues i obstruksionit të rëndësishëm. Kuantifikimi i fluksit ekspirator me spirometri është i thjeshtë dhe duhet të kryhet gjithmonë kur konsiderohet diagnoza e SPOK-ut.

Pacientët demonstrojnë shenja më të dukshme fizike, me agravimin progresiv të SPOK-ut. Këto përfshijnë: toraks në formë fuçie, frymëmarrje me buzë të mbledhura, dobësim të shprehur dhe hernie inguinale të shpeshta. Pacientët mund të qëndrojnë të ulur përpara dhe të mbështetur në bërryla, ose duke mbështetur pjesën e sipërme të trupit me krahët e zgjatur, në një pozitë të njohur si “tripod”. Ky pozicion stabilizon rrethin e shpatullave dhe ndihmon në maksimizimin e volumit intratorakal.

Hipertensioni pulmonar mund të dyshohet nisur nga një komponent i fortë pulmonar i tonit të dytë kardiak dhe tonet kardiake mund të zhvendosen medialisht, për shkak të hiperinflacionit.

Të Dhënat Laboratorike

Radiografia e toraksit

Radiografia e toraksit mund të ndihmojë në përjashtimin e patologjive të tjera, në pacientët me SPOK. SPOK-u është një diagnozë funksionale dhe radiografia mundet vetëm të sugjerojë këtë diagnozë. Trashësia e shtuar e mureve bronkiale dhe theksimi i vizatimit pulmonar, sugjerojnë diagnozën e bronkitit kronik, por nuk janë as specifike, as sensitive. Ekzistojnë dy modele roentgenografike të lidhura me emfizemën, megjithëse të dyja janë shenja të sëmundjes së vonshme. Këto modele janë: “deficiencia arteriale” dhe “theksimi i vizatimit pulmonar”. Triada e hiperinflacionit, oligemisë dhe bulave, përfshin modelin e “deficiencës arteriale” dhe shihet më shpesh në emfizemë. Modeli i “theksimit të vizatimit”, që i ngjan pamjes së “pulmonit të ndotur”, shihet në bronkit kronik. Evidenca më e mirë e hiperinflacionit është sheshimi i diafragmave, me një konkavitë të sipërfaqes superiore të diafragmës (Fig. 1).

Figura 1. Emfizema pulmonare



Tomografia e kompjuterizuar (CT) e toraksit nuk rekomandohet rutinë, përveç se, për zbulimin e bronkoektazive, si edhe te pacientët me SPOK, që plotësojnë kriteret për vlerësimin e rrezikut të kancerit të mushkërive. Prania e emfizemës, në veçanti, mund të rrisë rrezikun për zhvillimin e kancerit të mushkërive.

Spirometria

Spirometria është matja më e riprodhueshme dhe objektive, e kufizimit të fluksit të ajrit. Është një test jo-invaziv dhe i disponueshëm lehtësisht.

Kriteri spirometrik i obstruksionit, mbetet një raport fiks post-bronkodilatator i $FEV_1/FVC < 0,70$. Ky kriter është i thjeshtë, i pavarur nga vlerat e referencës dhe është përdorur në prova të shumta klinike, që formojnë bazën e evidencave, nga e cila nxirren shumica e rekomandimeve të trajtimit.⁽⁸⁸⁾ Duhet të theksohet se, përdorimi i raportit fiks FEV_1/FVC për të përcaktuar obstruksionin, mund të rezultojë në mbidiagnostikim të SPOK-ut tek të moshuarit, dhe nëndiagnozë tek adultët < 45 vjeç, sidomos në stadin e lehtë të SPOK-ut, krahasuar me përdorimin e një “cut-off” bazuar në Kufirin e Poshtëm të Normës (LLN) për FEV_1/FVC .⁽⁸⁹⁾

VLERËSIMI

Qëllimet e vlerësimit të SPOK-ut janë të përcaktojnë shkallën e obstruksionit, ndikimin e tij në gjendjen shëndetësore të pacientit dhe rrezikun në të ardhmen (të tilla si acarimet, shtrimet në spital, ose vdekja), në mënyrë që të drejtojnë eventualisht terapinë.

Për të arritur këto qëllime, vlerësimi i SPOK-ut, duhet të marrë parasysh secilin nga aspektet e mëposhtme të sëmundjes:

- Prania dhe graviteti i anomalive spirometrike.
- Natyra aktuale dhe shkalla e simptomave të pacientit.
- Historia e acarimeve të moderuara, ose të rënda dhe rrezikut në të ardhmen.
- Prania e sëmundjeve bashkëshoqëruese.

Klasifikimi i gravitetit të obstruksionit

Klasifikimi i gravitetit të obstruksionit në SPOK, tregohet në tabelën 1

Duhet të theksohet se, ekziston një korrelacion i dobët midis FEV₁, simptomave dhe dëmtimit të statusit shëndetësor të një pacienti.^(90,91) Për këtë arsye, kërkohet vlerësimi formal simptomatik.

Tabela 1. Graviteti i obstruksionit të SPOK-ut bazuar në spirometri.

KLASIFIKIMI I GRAVITETIT TË OBSTRUKSIONIT NË SPOK		
Në pacient me FEV ₁ /FVC < 0.70		
GOLD 1	i lehtë	FEV₁ ≥ 80% të vlerës së parashikuar
GOLD 2	mesatar	50% ≤ FEV₁ < 80% të vlerës së parashikuar
GOLD 3	i rëndë	30% ≤ FEV₁ < 50% të vlerës së parashikuar
GOLD 4	shumë i rëndë	FEV₁ < 30% të vlerës së parashikuar

Vlerësimi i simptomave

Këtu paraqesim dy matësit e simptomave, që përdoren më gjerësisht.

Në të kaluarën, SPOK-u shihej si një sëmundje e karakterizuar kryesisht nga dispnea. Një matës i thjeshtë i dispnesë, si Pyetësi i Modifikuar i Këshillit Britanik të Kërkimit Mjekësor (mMRC)⁽⁹²⁾ (Tabela 2), u konsiderua i përshtatshëm për vlerësimin e simptomave, pasi mMRC korrelohet mirë me matësit e tjerë të statusit shëndetësor⁽⁹³⁾ dhe parashikon rrezikun e vdekshmërisë në të ardhmen.⁽⁹⁴⁾

Tabela 2. Pyetësi i Modifikuar, i Këshillit Britanik të Kërkimit Mjekësor, për vlerësimin e dispnesë.

SHKALLËZIMI I MODFIKUAR MRC I DISPNESE		
Ju lutem shënoni në kutinë që ju përshtatet	1 kuti vetëm	Gradët 0-4
mMRC Grada 0.	Kam dispne, vetëm në ushtrime të forta.	<input type="checkbox"/>
mMRC Grada 1.	Kam dispne kur nxitoj në plan të sheshtë, ose ngjis malore të lehtë.	<input type="checkbox"/>
mMRC Grada 2.	Eci më ngadalë se moshatarët e mi, në plan të sheshtë, për shkak të dispnesë, ose më duhet të ndaloj për të marrë frymë, kur eci me hapin tim, në plan të sheshtë.	<input type="checkbox"/>
mMRC Grada 3.	Ndaloj për të marrë frymë, pasi kam ecur afërsisht 100 metra, ose pas disa minutave, në plan të sheshtë.	<input type="checkbox"/>
mMRC Grada 4.	Kam tepër dispne, për të dalë nga shtëpia, ose kam dispne, edhe kur vishem apo çvishem.	<input type="checkbox"/>

Sidoqoftë, tani dihet që SPOK-u ndikon te pacientët përtej dispnesë (95). Për këtë arsye, rekomandohet një vlerësim gjithëpërfshirës i simptomave, krahasuar me thjesht një matje të dispnesë. Për këtë arsye janë zhvilluar dhe kanë rezultuar të përshtatshëm, Testi i Vlerësimit të SPOK-ut (CAT) dhe Pyetësi i Kontrollit të SPOK-ut (CCQ ©).

Testi i Vlerësimit të SPOK-ut (CAT).

Testi i Vlerësimit të SPOK-ut, është një matës unidimensional me 8 pika, i dëmtimit të gjendjes shëndetësore në SPOK, si në Tabelën 3.⁽⁹⁶⁾ Ai është zhvilluar për t'u zbatuar në të gjithë botën dhe përkthimet e validuara janë në dispozicion në një gamë të gjerë gjuhësh. Rezultati varion nga 0-40, lidhet shumë ngushtë me SGRQ dhe është dokumentuar gjerësisht, në botime të shumta.⁽⁹⁷⁾

Tabela 3. CAT (Testi i Vlerësimit të SPOK-ut)

Për çdo fjali më poshtë, vendosni shenjen (X) në kutinë që përshkruan më së miri gjendjen tuaj aktuale. Kini kujdes që për secilën pyetje të zgjidhni vetëm një përgjigje.

Shembull: Jam shumë i lumtur (0) (X) (2) (3) (4) (5) Jam shumë i mërziur

	0	1	2	3	4	5	REZULTATI	
Nuk kollitem asnjëherë	0	1	2	3	4	5	Kollitem gjatë gjithë kohës	
Nuk kam aspak këlbazë në kraharor	0	1	2	3	4	5	Kam shumë këlbazë në kraharor	
Nuk ndjej aspak shtrëngim në kraharor	0	1	2	3	4	5	Ndjej shumë shtrëngim në kraharor	
Nuk mbetem pa frymë kur ngjitem në një kodër ose në një palë shkallë	0	1	2	3	4	5	Mbetem pa frymë kur ngjitem në një kodër ose në një palë shkallë	
Nuk jam i kufizuar në kryerjen e aktiviteteve në shtëpi	0	1	2	3	4	5	Jam shumë i kufizuar në kryerjen e aktiviteteve në shtëpi	
Ndjem i sigurt që të largohem nga shtëpia, pavarësisht nga sëmundja ime e mushkërive	0	1	2	3	4	5	Nuk ndjem aspak i sigurt që të largohem nga shtëpia, për shkak të sëmundjes sime të mushkërive	
Bëj gjumë të mirë	0	1	2	3	4	5	Nuk bëj gjumë të mirë për shkak të sëmundjes sime të mushkërive	
Kam shumë fuqi	0	1	2	3	4	5	Nuk kam aspak fuqi	
REZULTATI TOTAL								



Sigurohuni që të printoni pyetësin tuaj CAT para se të shkoni tek mjeku juaj

Vlerësimi i Rrezikut të Acarimeve

Acarimet e SPOK-ut përcaktohen si një përkeqësim akut i simptomave respiratore, që rezultojnë në terapi shtesë.^(98, 99) Këto ngjarje klasifikohen si të lehta [të trajtuara vetëm me bronkodilatatorë me veprim të shkurtër (SABD)], të moderuara (të trajtuara me SABD plus antibiotikë dhe/ose kortikosteroidë oralë), ose të rënda (pacientit i nevojitet shtrim në spital, ose paraqitet në urgjencë). Acarimet e rënda mund të shoqërohen, gjithashtu, me insuficiencë respiratore akute.

Vlerësimi i sëmundjeve kronike shoqëruese (sëmundjet bashkëshoqëruese)

Pacientët me SPOK shpesh kanë sëmundje të rëndësishme bashkëshoqëruese kronike, në kohën e diagnozës dhe vetë SPOK-u, përfaqëson një komponent të rëndësishëm të multimorbiditetit, veçanërisht tek të moshuarit, si përgjigje ndaj faktorëve të përbashkët të rrezikut (p.sh. plakja, pirja e duhanit, alkooli, dieta dhe pasiviteti).^(100,101) Vetë SPOK-u, gjithashtu, ka efekte të rëndësishme ekstrapulmonare (sistemike), duke përfshirë humbjen e peshës, anomalitë e ushqyerjes dhe mosfunksionimin e muskujve të skeletit. Mosfunksionimi i muskujve të skeletit, karakterizohet si nga sarkopenia (humbja e qelizave të muskujve), ashtu edhe nga funksioni jonormal i qelizave të mbetura.⁽¹⁰²⁾ Shkaqet e tij ka të ngjarë të jenë multi-faktorialë (p.sh. pasiviteti, dieta e varfër, inflamacioni dhe hipoksia) dhe mund të kontribuojë në intolerancë ndaj efortit dhe gjendje shëndetësore të keqe, në pacientët me SPOK. E rëndësishme është që, mosfunksionimi i muskujve të skeletit, është një shkak i korigjueshëm i intolerancës ushtrimore.⁽¹⁰³⁾

Sëmundjet e zakonshme bashkëshoqëruese përfshijnë: sëmundjet kardiovaskulare (105), disfunksionin e muskujve skeletikë, sindromën metabolike, osteoporozën, depresionin, ankthin dhe kancerin e mushkërive.

Vlerësimi i kombinuar i SPOK-ut

Të kuptuarit e mirë të ndikimit që ka SPOK-u në një pacient individual, kombinon vlerësimin simptomatik, me klasifikimin spirometrik të pacientit dhe/ose rrezikun e acarimeve. Mjeti i vlerësimit "ABCD" i GOLD-it 2011, i përditësuar, është një hap i madh përpara, krahasuar me sistemin thjeshtë të vlerësimit spirometrik, të versioneve të mëparshme të GOLD-it, sepse përfshinte rezultate të raportuara nga pacientët dhe theksoi rëndësinë e parandalimit të acarimeve, në menaxhimin e SPOK-ut. Sidoqoftë, ai kishte disa kufizime të rëndësishme. Së pari, mjeti i vlerësimit ABCD, nuk performoi më mirë sesa klasifikimi spirometrik, për parashikimin e vdekshmërisë, apo rezultateve të tjera të rëndësishme shëndetësore në SPOK.^(104,105) Për më tepër, rezultatet e grupit "D" u modifikuan nga dy parametra: funksioni pulmonar dhe/ose historia e acarimeve, i cili shkaktoi konfuzion. Për të adresuar këto dhe shqetësime të tjera, duke ruajtur në të njëjtën kohë qëndrueshmërinë dhe thjeshtësinë për mjekun praktikues, u propozua një përsosje e mjetit të vlerësimit ABCD, që ndan klasifikimet spirometrike nga grupet "ABCD". Për disa rekomandime terapeutike, grupet ABCD do të rrjedhin ekskluzivisht nga simptomat e pacientit dhe historia e tyre e acarimeve. Spirometria, së bashku me simptomat e pacientit dhe historinë e acarimeve të moderuara dhe të rënda, mbetet thelbësore për diagnozën, prognozën dhe shqyrtimin e qasjeve të tjera të rëndësishme terapeutike.

Në skemën e vlerësimit të rishikuar, pacientët duhet t'i nënshtrohen spirometrisë, për të përcaktuar gravitetin e obstruksionit (d.m.th. “grada spirometrike”). Ata gjithashtu, duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të dispnesë, duke përdorur mMRC, ose simptomave, duke përdorur CAT. Në fund, duhet të regjistrohet historia e tyre e acarimeve të moderuara dhe të rënda (përfshirë shtrimet e mëparshme në spital).

Numri siguron informacion në lidhje me gravitetin e obstruksionit (“grada spirometrike” 1-4), ndërsa shkronja (grupet A, B, C, D) jep informacion në lidhje me shkallën e simptomave dhe rrezikun e acarimit, të cilat mund të përdoren për të drejtuar terapinë. FEV₁ është një parametër shumë i rëndësishëm, në nivelin e popullatës, në parashikimin e rezultateve të rëndësishme klinike, si vdekshmëria dhe shtrimet në spital, ose për shqyrtimin e shpejtë të terapisë jo-farmakologjike si: reduktimi i volumit pulmonar, ose transplanti i mushkërive. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se, në nivelin individual të pacientit, FEV₁ humbet saktësinë dhe kështu nuk mund të përdoret i vetëm, për të përcaktuar të gjitha opsionet terapeutike. Për më tepër, në disa rrethana të tilla si: gjatë shtrimit në spital, ose paraqitjes urgjente në klinikë, ose urgjencë, aftësia për të vlerësuar pacientët bazuar në simptomat dhe historinë e acarimeve, të pavarur nga vlerat spirometrike, lejon klinikistët të fillojnë një plan trajtimi bazuar vetëm në skemën e rishikuar ABCD. Kjo qasje vlerësimi, njeh kufizimet e FEV₁-it në marrjen e vendimeve të trajtimit, për kujdesin e individualizuar të pacientit dhe thekson rëndësinë e simptomave të pacientit dhe rrezikun e acarimeve, në drejtimin e terapive në SPOK. Ndarja e obstruksionit nga parametrat klinikë, e bën më të qartë se çfarë vlerësohet dhe klasifikohet. Kjo do të lehtësojë rekomandime më të sakta të trajtimit, bazuar në parametrat që po nxisin simptomat e pacientit, në çdo kohë të dhënë.

Figura 2. Vlerësimi i SPOK-ut sipas ndarjes në grupe





Figura 3. Skema e trajtimit të SPOK-ut sipas ndarjes në grupe

TRAJTIMI FARMAKOLOGJIK SIPAS GOLD



PARANDALIMI DHE TERAPIA MBAJTËSE

Ndërprerja e pirjes së duhanit

Ndërprerja e pirjes së duhanit, ndikon shumë në historinë natyrore të SPOK-ut. Nëse ndërprerjes së pirjes së duhanit, i kushtohet vëmendje e veçantë, burimet dhe koha efektive, mund të arrihen nivele afatgjata të suksesit deri në 25%.⁽¹⁰⁶⁾ Përveç qasjeve individuale për ndërprerjen e pirjes së duhanit, masat legjislative për ndalimin e pirjes së tij, janë efektive në rritjen e niveleve të lënies së duhanit dhe zvogëlimin e dëmit nga ekspozimi ambjental ndaj tymit të tij.⁽¹⁰⁷⁾

Vaksinimet

- **Vaksina e gripit**

Vaksinimi ndaj gripit, mund të reduktojë sëmundjet serioze (të tilla si infeksionet e traktit të poshtëm respirator, që kërkojnë shtrimin në spital) dhe vdekjen në pacientët me SPOK.^(108,109)

- **Vaksina pneumokoksike**

Vaksinimet pneumokoksike, PCV13 dhe PPSV23, rekomandohen për të gjithë pacientët ≥ 65 vjeç. PPSV23 rekomandohet, gjithashtu, për pacientët më të rinj me SPOK dhe sëmundje të rëndësishme shoqëruese, duke përfshirë sëmundjet kronike të zemrës ose mushkërive (110).

TERAPIA FARMAKOLOGJIKE PËR SPOK-un STABËL

Bronkodilatatorët

Bronkodilatatorët janë barna që rrisin FEV₁ dhe/ose ndryshojnë variabla të tjerë spirometrikë. Ata veprojnë duke ndryshuar tonusin e muskujve të lëmuar të rrugëve ajrore dhe përmirësimet në fluksin ekspirator, pasqyrojnë më shumë zgjerimin e rrugëve ajrore, sesa ndryshimet në tërheqjen elastike të pulmoneve. Bronkodilatatorët tentojnë të zvogëlojnë hiperinflacionin dinamik, në qetësi dhe gjatë efortit,^(111,112) duke përmirësuar rrjedhimisht performancën ushtrimore. Shkalla e këtyre ndryshimeve, veçanërisht në pacientët me SPOK të rëndë dhe shumë të rëndë, nuk është e lehtë të parashikohet nga përmirësimi i FEV₁ i matur në qetësi.⁽¹¹³⁾

Agonistët beta2

Veprimi kryesor i beta 2-agonistëve është të relaksojnë muskujt e lëmuar të rrugëve ajrore, duke stimuluar receptorët beta 2-adrenergjikë. Ky stimulim rrit AMP ciklike dhe prodhon antagonizëm funksional ndaj bronkokonstriksionit. Beta 2-agonistët janë me veprim të shkurtër (SABA) dhe veprim të gjatë (LABA). Efekti i SABA-ve, zakonisht zhduket brenda 4-6 orëve. Përdorimi i rregullt dhe sipas nevojës i SABA-ve, përmirëson FEV₁ dhe simptomat.⁽¹¹⁴⁾ LABA-t kanë kohëzgjatje të veprimit ≥ 12 orë dhe nuk përjashtojnë përfitime shtesë nga terapia me SABA, sipas nevojës.⁽¹¹⁵⁾

Preparatet Antimuskarinike

Barnat antimuskarinike bllokojnë efektet bronkokonstriktive të acetilkolinës, në receptorët muskarinikë M3, të pranishëm në muskujt e lëmuar të rrugëve ajrore.⁽¹¹⁶⁾ Antimuskarinikët me veprim të shkurtër (SAMA-t), përkatësisht: ipratropiumi dhe oxitropiumi, bllokojnë gjithashtu receptorin neuronal inhibitor M2, i cili potencialisht mund të shkaktojë bronkokonstriksion të induktuar nga nervi Vagus. Antimuskarinikët me veprim të gjatë (LAMA-t), të tillë si: tiotropium, aclidinium, glycopyrronium bromide dhe umeclidinium, kanë lidhje të gjatë me receptorët muskarinikë M3, me disocijimm më të shpejtë nga receptorët muskarinikë M2. Kjo rezulton në shtim të kohëzgjatjes së efektit bronkodilatator.⁽¹¹⁶⁾

Metilksantinat

Ekzistojnë ende polemika, për efektet e sakta të derivateve të ksantinës. Ata mund të veprojnë si frenues jo-selektivë të fosfodiesterazës, por gjithashtu është raportuar të kenë një sërë veprimesh jo-bronkodiletatore, rëndësia e të cilave është e diskutueshme.^(117,118) Të dhënat për kohëzgjatjen e veprimit për ksantinën konvencionale, ose edhe ato me çlirim të ngadaltë, mungojnë në SPOK.

PREPARATET ANTI-INFLAMATORË

Kortikosteroidët e Inhaluar (CSI)

Konsideratat e përgjithshme paraprake. Provat in vitro, sugjerojnë që inflamacioni në SPOK, paraqet përgjigje të kufizuar ndaj kortikosteroidëve. Për më tepër, disa medikamente përfshirë beta-agonistët, teofilina ose makrolidët, mund të përmirësojnë pjesërisht ndjeshmërinë ndaj kortikosteroidëve në SPOK.^(119, 120) Rëndësia klinike e këtij efekti, nuk është përcaktuar ende plotësisht.

Efikasiteti i CSI-ve (i vetëm). Shumica e studimeve kanë zbuluar se trajtimi i rregullt vetëm me CSI, nuk modifikon rënien afatgjatë të FEV₁ dhe as vdekshmërinë, në pacientët me SPOK.⁽¹²¹⁾

CSI në kombinim me terapinë bronkodiletatore me veprim të gjatë. Në pacientët me SPOK dhe acarime të moderuara deri në shumë të rënda, një CSI i kombinuar me një LABA, është më efektiv sesa cilido nga përbërësit më vete, në përmirësimin e funksionit pulmonar, statusit shëndetësor dhe reduktimin e acarimeve.^(122,123) Provat klinike, të fokusuara në të gjitha shkaqet e mortalitetit si rezultat primar, dështuan të demonstrojnë një efekt statistikisht të rëndësishëm të terapisë së kombinuar, mbi mbijetesën.⁽¹²⁴⁾

Inhibitorët e Fosfodiesterazës-4 (PDE4)

Efikasiteti. Veprimi kryesor i inhibitorëve të PDE4, është zvogëlimi i inflamacionit, duke inhibuar zbërthimin e AMP ciklike intraqelizore.⁽¹²⁵⁾ Roflumilast zvogëlon acarimet mesatare dhe të rënda, të trajtuara me kortikosteroidë sistemikë, në pacientët me bronkit kronik, SPOK të rëndë deri në shumë të rëndë dhe një histori të acarimeve.⁽¹²⁶⁾

Antibiotikët

Në studimet e mëparshme, përdorimi i vazhdueshëm profilaktik i antibiotikëve, nuk kishte asnjë efekt në frekuencën e acarimeve të SPOK-ut.^(127,128) Një studim që investigoi efikasitetin e kimioprofilaksisë, së ndërmarrë në muajt e dimrit, për një periudhë prej 5 vitesh, arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë përfitim. Studime të mëvonshme, kanë treguar se përdorimi i rregullt i disa antibiotikëve, mund të zvogëlojë shkallën e acarimeve.

Azitromicina (250 mg në ditë ose 500 mg tri herë në javë), ose eritromicina (500 mg dy herë në ditë) për një vit, në pacientë të prirur ndaj acarimeve, zvogëlojnë rrezikun e tyre në krahasim me kujdesin e zakonshëm.^(129,130) Nuk ka të dhëna që tregojnë efikasitetin, ose sigurinë e trajtimit kronik me azitromicinë, për të parandaluar acarimet e SPOK-ut përtej 1 viti të trajtimit.

Mukolitikët (Mukokinetikët, Mukorregullatorët) dhe Agjentët Antioksidantë (NAC, Karbocisteinë, Erdosteinë)

Në pacientët me SPOK-ut, që nuk marrin kortikosteroidë inhalatorë, trajtimi i rregullt me mukolitikë të tillë si erdosteinë, karbocisteinë dhe N-acetilcisteinë, mund të reduktojë acarimet dhe të përmirësojë në shkallë modeste statusin shëndetësor (131, 132).

Terapia shtesë me Alfa-1 Antitripsinë

Një terapi e tillë ka qenë e disponueshme në shumë vende, por jo në të gjitha, që nga vitet 1980. Për shkak se deficienca e Alpha-1 Antitripsinës është e rrallë, nuk janë ndërmarrë prova klinike formale, për të vlerësuar efikasitetin e trajtimit me rezultatin konvencional spirometrik. Megjithatë, një mori studimesh vëzhguese, sugjerojnë një reduktim të progresionit spirometrik në pacientët e trajtuar, kundrejt atyre të patrajtuar dhe se ky reduktim është më efektiv për pacientët me FEV₁ 35-49% të vlerës së parashikuar.⁽¹³³⁾

Antitusivët

Roli i antitusivëve në pacientët me SPOK është i paqartë.⁽¹³⁴⁾

TEZA

BARRA E SËMUNDJEVE PULMONARE OBSTRUKTIVE KRONIKE NË SHQIPËRI

Në vitin 1998, me bashkëpunimin e Institutit Kombëtar të Zembrës, Mushkërive dhe Gjakut, (NHBLI) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, u implementua Iniciativa Globale për Sëmundjen Obstruktive Kronike të Mushkërive (GOLD). Qëllimet e saj përfshinin rritjen e ndërgjegjësimit për barrën e SPOK-ut dhe përmirësimin e parandalimit dhe menaxhimit të SPOK-ut, përmes një përpjekjeje të përbashkët të të gjithë faktorëve, të përfshirë në të gjitha aspektet e kujdesit shëndetësor dhe politikës së kujdesit shëndetësor. Një qëllim i rëndësishëm dhe pasues, është inkurajimi i interesit më të madh kërkimor për këtë sëmundje shumë të përhapur.

Pavarësisht ekzistencës së udhëzuesëve diagnostikë dhe terapeutikë, të bazuar në evidenca, shumë pacientë me SPOK vazhdojnë të mos diagnostikohen ose të keqdiagnostikohen. SPOK-u mund të mbetet i padiagnostikuar, për disa arsye: pacientët mund të mos paraqiten te mjeku, sepse janë mësuar me simptomat; mund të mendojnë që simptomat e tyre respiratore janë të vetëshkaktuara, ose nuk janë të sigurt nëse SPOK-u mund të trajtohet. Për më tepër, spirometria është e nënpërdorur dhe mund të jetë e vështirë për t'u interpretuar nga disa ofrues të kujdesit shëndetësor. Edhe më tej, Astma dhe SPOK-u mund të ngatërrohen, pasi secila prej tyre mund të shfaqë obstruksion fiks të fluksit të ajrit. Depistimi i SPOK-ut, që përqendrohet vetëm te pacientët që përmbushin një grup të kufizuar karakteristikash të tilla si, pirësit e duhanit në moshë të vjetër, mund të mos zbulojë SPOK-un midis individëve në popullatën e përgjithshme (p.sh. të rriturit më të rinj me sëmundje të hershme), ose midis atyre ku SPOK-u ka një etiologji tjetër (p.sh. ekspozimi në punë).

Një problem i madh, është mungesa e informacionit në lidhje me prevalencën dhe barrën ekonomike dhe sociale të SPOK-ut, veçanërisht në vendet në zhvillim. Kjo mungesë informacioni, rezulton në një kuptim jo të plotë të ndikimit esencial të sëmundjes në cilësinë e jetës dhe në kostot direkte dhe indirekte të kujdesit shëndetësor.

Iniciativa për Barrën e Sëmundjes Obstruktive Kronike të Mushkërive (BOLD-i) u krijua për të zhvilluar modele të fuqishme, që mund të përdoren për të vlerësuar prevalencën dhe barrën ekonomike aktuale dhe të ardhshme të SPOK-ut. Një bazë e saktë e të dhënave të prevalencës së SPOK-ut dhe një mjet për të projektuar barrën ekonomike dhe sociale, do të ndihmonte në informimin e qeverive dhe planifikuesve të shëndetit. Baza e të dhënave, duhet të dokumentojë ndikimin e sëmundjes në lidhje me kufizimin e aftësisë, kostot e kujdesit shëndetësor dhe cilësinë e dëmtuar të jetës. Për të qenë më e dobishme, një bazë e tillë e të dhënave u zhvillua nga studime të bazuara në popullatë, duke përdorur metoda të standardizuara. Hapi i parë ishte zhvillimi i metodave të standardizuara, që mund të përdoren në të gjitha vendet, pavarësisht nivelit të zhvillimit ekonomik. Disponueshmëria e metodave të standardizuara, bëri të mundur vlerësimin e prevalencës dhe krahasimin e prevalencave brenda të njëjtës zonë gjeografike dhe midis zonave të ndryshme gjeografike. Metodave të standardizuara, gjithashtu, do të lejonin studiuesit të eksploronin ndryshimet në SPOK-ut, të vëzhguara midis zonave të ndryshme dhe të përcaktonin në mënyrë sasiore rrezikun që i atribuohet

ekspozimeve të ndryshme. Si shtesë e të dhënave për prevalencën e SPOK-ut, të marra nga studimet e bazuara në popullatë, sidomos edhe për vendet ku nuk mund të bëhet një studim i prevalencës me fuqi të plotë, modelimi i prevalencës së SPOK-ut dhe barrës së tij ekonomike, mund të përdoret për të vlerësuar nevojat dhe kostot e kujdesit shëndetësor.

QËLLIMI & ARSYETIMI

Vlerësimi prevalencës të SPOK-ut dhe faktorëve të rrezikut, që kontribuojnë në zhvillimin e SPOK-ut.

Nisur nga fakti që në Shqipëri nuk ka të dhëna në lidhje me SPOK-un, vlerësimi i prevalencës së tij, është i nevojshëm për të dokumentuar efektin e kësaj patologjie mbi kufizimin e aftësisë, kostot e kujdesit shëndetësor, cilësinë e dëmtuar të jetës dhe për të informuar qeveritë dhe planifikuesit e shëndetit. Si plotësim i të dhënave të marra nga studimet e bazuara në popullatë, sidomos dhe për Shqipërinë, ku nuk mund të bëhet një studim i prevalencës me fuqi të plotë, modelimi i prevalencës së SPOK-ut dhe barrës së tij ekonomike, mund të ndihmojë në vlerësimin e nevojave dhe kostove të mundshme të kujdesit shëndetësor.

Asnjë studim i prevalencës së SPOK-ut, nuk është bërë në Shqipëri deri më sot. Por, siç është cituar edhe më parë, SPOK-u mbetet një sëmundje e nëndiagnostikuar dhe e nëntrajtuar. Ka shumë faktorë kontribues, disa prej të cilëve u përmendën më lart, por në praktikën tonë të përditshme përballemi shpesh me pacientë me SPOK në fazë të avancuar/të rëndë, madje edhe me insuficiencë respiratore, që shtrohen në spital, të cilët nuk kanë qenë të diagnostikuar dhe trajtuar më parë për SPOK.

Shqipëria është një vend post-komunist, që po kalon një periudhë tranzicioni të gjatë dhe të vështirë. Pirja e duhanit është një fenomen shumë i përhapur dhe ne mendojmë se ky mbetet faktori kryesor i rrezikut, për zhvillimin e SPOK-ut. Disa studime të kryera në Shqipëri, që synojnë të vlerësojnë prevalencën e pirjes së duhanit, treguan se 35% e meshkujve ≥ 38 vjeç, ishin duhanpirës aktualë. Faktorë të tjerë të rëndësishëm të rrezikut për zhvillimin e SPOK-ut, janë ndotja e mjedisit, që lidhet kryesisht me përdorimin e karburantit me cilësi të keqe, përdorimin e naftës dhe automjeteve të vjetra.

Një faktor tjetër rreziku që kontribuon në zhvillimin e SPOK-ut, janë infeksionet respiratore, veçanërisht ato të kaluara gjatë fëmijërisë, që janë mjaft të përhapura në vendin tonë.

Duke marrë në konsideratë të gjitha arsyet e lartpërmendura, Shoqata Respiratore Shqiptare, në bashkëpunim me Përfaqësuesin Lokal të Glaxo Smith Kline (GSK) në Shqipëri, filloi negociatat në lidhje me zbatimin e studimit të barrës së SPOK-ut në Shqipëri. Metodrat e standardizuara ishin të domosdoshme, që studimi të ishte shkencor dhe sa më afër realitetit. Kjo do të arrihej, në rastin më të mirë, nëse do të ishim pjesë e studimit të BOLD-it, të zbatuar në të gjithë botën.

Duke pasur parasysh këtë, pasi GSK në Shqipëri vendosi të mbështesë financiarisht këtë studim, ne aplikuan në Qendrën Operacionale (OC), Londër, për të marrë pjesë në studimin e BOLD-it. Propozimi ynë u mirëprit nga përfaqësuesit e BOLD-it, dhe

falënderime të veçanta nga ana jonë i shkojnë së pari Prof. Peter Burney për gatishmërinë e tij, së bashku me të gjithë stafin e tij, për të mbështetur të gjitha përpjekjet tona drejt një zbatimi të suksesshëm të projektit. Për më tepër, ky studim ishte i rëndësishëm edhe për qendrën BOLD-it, sepse Shqipëria ishte i vetmi vend në rajonin e Ballkanit, që kreu një studim të tillë.

Qendra Operacionale e BOLD-it siguroi trajnim, materiale, kontroll të cilësisë dhe analiza të të dhënave për Shqipërinë. BOLD-it theksoi kontrollin e cilësisë së të dhënave, në çdo fazë të procesit. Të dhënat nga formularët, të plotësuar në terren, u hodhën në mënyrë elektronike në një platformë të sigurt Web, të krijuar posaçërisht. Testi i spirometrisë, para dhe pas bronkodilatatorit, u bë në të gjithë pjesëmarrësit dhe të gjitha të dhënat e spirometrisë u dërguan dhe u kontrolluan për cilësinë në Qendrën Operacionale. Pyetësorët BOLD-it u përkthyen dhe u përdorën për të marrë informacion, në lidhje me simptomat respiratore, gjendjen shëndetësore, ekspozimin ndaj faktorëve të rrezikut dhe të dhëna ekonomike në lidhje me barrën e SPOK-ut. Metodatat e standardizuara të BOLD-it, siguruan një mënyrë uniforme për të krahasuar barrën e SPOK-ut brenda dhe midis vendeve dhe aty ku u gjetën ndryshime, për të eksploruar shpjegimet për këto ndryshime.

Studimi BOLD-it në Shqipëri është një studim “cross-sectional”, dhe drejtuesi kryesor ishte Prof. Dr. Hasan Hafizi FCCP. Nëntë mjekë u rekrutuan për punën në terren (1 epidemiolog, 5 pneumologë dhe 3 specializantë të Pulmonologjisë).

Mbështetja financiare përkatëse, u dha nga Glaxo Smith Kline. Ekipi BOLD-it siguroi ndihmë të vazhdueshme teknike.

Studimi u miratua nga Komiteti Kombëtar i Etikës, sepse ishte parakusht nga Qendra Operacionale në Londër, për fillimin e zbatimit të studimit.

Me synimin për të siguruar një kohort të ri duhanpirësish, që do të vlerësohej në të ardhmen, së bashku me studimin kryesor, por që nuk konsiderohet si pjesë e BOLD-it, u zbatua njëkohësisht një tjetër studim i prevalencës së pirjes së duhanit, me pjesëmarrës të moshës 18-39 vjeç. Të gjithë pjesëmarrësit plotësuan një pyetësor, që përmban të dhëna në lidhje me demografinë, statusin arsimor, statusin e pirjes së duhanit dhe simptomat respiratore (kollë në mëngjes, sputum dhe/ose dispne).

OBJEKTIVAT DHE QËLLIMET E PËRFUNDIMTARE

Objektivat kryesorë:

1. TË VLERËSOJË PREVALENCËN E SPOK-ut NË SHQIPËRI.
2. TË VLERËSOJË PREVALENCËN E PIRJES SË DUHANIT NË SHQIPËRI.

Objektivat dytësorë:

1. Të përcaktojë faktorët e rrezikut, që kontribuojnë në prevalencën e SPOK-ut.
2. Të përshkruajë shpërndarjen e SPOK-ut sipas moshës, seksit dhe historisë së pirjes së duhanit.
3. Të përshkruajë shpërndarjen e pirjes së duhanit, sipas grupmoshave dhe seksit.
4. Të përshkruajë simptomat kryesore klinike, të raportuara nga subjektet e diagnostikuar me SPOK.
5. Të vlerësojë shkallën e diagnostikimit të SPOK-ut nga mjekët e familjes.
6. Të krahasojë ndikimin në prevalencën e SPOK-ut, të përdorimit të përkufizimeve të ndryshme të përcaktimit të diagnozës së SPOK-ut, përfshirë ato të propozuara nga Shoqata Amerikane e Toraksit, Shoqata Respiratore Evropiane dhe GOLD-i.

METODA E STUDIMIT

Studim “cross-sectional”.

Studimi i prevalencës së SPOK-ut, në të rriturit e moshës ≥ 40 vjeç.

Një mostre përfaqësuese të individëve në këtë rang moshe, iu kërkua të plotësojë pyetësorët e hartuar nga BOLD-i.

Këtyre individëve iu është kërkuar, gjithashtu, t'u matet funksioni i mushkërive para dhe pas administrimit të një bronkodilatori me veprim të shkurtër.

Numri i pjesëmarrësve në këto grupmosha, në mostrat urbane dhe rurale: 600 burra dhe 600 gra.

Në mënyrë që të zhvillojmë vlerësime të vlefshme të barrës së ardhshme të sëmundjes, ne studiuam edhe një grup shtesë të individëve të moshës 18-39 vjeç, me qëllimin e mbledhjes së informacionit, mbi prevalencën e pirjes së duhanit dhe faktorëve të tjerë kryesorë të rrezikut në këto grupe. Sidoqoftë, nga këta individë, nuk u kërkua matje e funksionit të mushkërive.

METODAT

Përzgjedhja dhe rekrutimi i popullsisë së studimit

Është zgjedhur një mostër përfaqësuese e të gjithë vendit.

Popullsia e synuar është: burra dhe gra të moshës ≥ 40 vjeç.

Procedura e zgjedhjes të mostrave:

- U zgjodh një mostër prej 1200 individësh (600 burra dhe 600 gra) të moshës ≥ 40 vjeç, bazuar në të dhënat e disponuara në Institutin kombëtar të Statistikave (INSTAT), sipas planit të kampionimit të imponuar nga Qendra Operacionale.
- Sipas INSTAT, korniza e marrjes së mostrave përbëhej nga 1,168,721 burra dhe gra të moshës ≥ 40 vjeç. Në studim u rekrutuan gjithashtu edhe 1200 individë shtesë të moshës 18-39 vjeç (600 burra dhe 600 gra), vetëm për plotësimin e pyetësorit minimal. Qendra Operacionale në Londër, shqyrtoi dhe aprovoi metodologjinë e kërkimit dhe përjasjen e seleksionimit të mostrave, të implementuar nga eksperti ynë lokal.

VLERËSIMET DHE PROCEDURAT

Përzgjedhja dhe rekrutimi i popullsisë në studim

Rekrutimi i pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit u kontaktuan përmes vizitave në shtëpi dhe iu kërkua që të japin aprovim, pasi të ishin informuar, mbi dakordësinë e pjesëmarrjes në studim. Për përzgjedhjen e tyre, bashkëpunuam me mjekët e familjes, të cilët na vunë në dispozicion regjistrin e personave banues në lagjet përkatëse, si edhe na ndihmuan në organizimin e vizitave.

Pyetësorët janë hartuar nga BOLD-i.

Të gjithë pjesëmarrësit, të cilët ranë dakord të merrnin pjesë në studim, duhej të plotësonin pyetësorët e BOLD-it.

Spirometria

Për spirometrinë u zbatuan metoda të standardizuara, sipas kritereve të BOLD-it. Testet e spirometrisë u kryen para dhe pas përdorimit të një bronkodilatatori. SPOK-u u përcaktua si një kufizim i fluksit të ajrit post-bronkodilatator, sipas $FEV_1/FVC < 70\%$

Regjistrimi dhe Menaxhimi i të Dhënave

Të dhënat për BOLD-in konsistonin në rezultatet e spirometrive të ngarkuara në mënyrë elektronike, pyetësorët e plotësuar nga pjesëmarrësit në studim, të dhënat individuale të gjurmimit dhe të dhënat e përgjithshme për popullatën “target”. Këto të fundit përfshinin të dhëna demografike, informacione mbi statusin socio-ekonomik dhe të dhëna mbi cilësinë e ajrit për zonën gjeografike në të cilën banonte popullata e targetuar.

Pasi mbaroi mbledhja e të dhënave, Qendra Operacionale na siguroi një kopje elektronike të të dhënave, që ata përdorën për kryerjen e analizave specifike. Një kopje e të dhënave u ruajt në Qendrën Operacionale për analiza “pooled, cross-site”.

Kontrolli i cilësisë:

U përdorën metoda strikte të kontrollit të cilësisë, për të siguruar që të gjitha vendet t'i bëjnë sondazhet në një mënyrë të standardizuar, duke përfshirë:

- Zgjedhjen e mostrës së popullsisë.
- Rekrutimin e pjesëmarrësve.
- Spirometrinë.
- Pyetësorët.
- Transferimin e të dhënave dhe analizën e tyre.

Qendra Operacionale kishte për detyrë, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë për sjelljen shkencore të BOLD-it.

Analiza e të dhënave

Qendra Operacionale, gjeneroi një raport bazë statistikor për të dhënat dhe na e ktheu këtë raport të përpunuar, së bashku me databazën e pastruar të faqes, në përfundim të aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave të faqes tonë.

OBJEKTIVAT OPERATIVE

FAZA 1:

- Njohja e Manualit të Proçedurave të metodave të standardizuara, të rekomanduara nga qendra e BOLD-it, që u përdorën në Shqipëri për të vlerësuar prevalencën e SPOK-ut.
- Përkthimi i pyetësorëve, nga anglisht në shqip dhe me tej nga shqipja në anglisht.
- Pilotimi i plotësimit të pyetësorëve, në një mostër të vogël.
- Trajnimi qendror i ekipit lokal bashkërendues (kryer në Londër, nga qendra e BOLD-it).

Planet e zgjedhjes së mostrave

- Paraqitja e dokumentacionit për aprovim nga Komiteti lokal i Etikës.
- Përgatitja e materialeve lokale të trajnimit.
- Rekrutimi dhe trajnimi i stafit lokal (intervistues, teknikienë).
- Studimi logjistik pilot. Dërgimi i testeve për çertifikim.
- Rezervimi i vizitave studimore.
- Përgatitja e dosjeve të pjesëmarrësve (pyetësorët) dhe pajisjet (spirometra, spireta, peshore, Ventolinë etj).
- Bashkëpunimi me Qendrën Operacionale në Londër për të siguruar mbikëqyrje, trajnim, materiale, kontroll të cilësisë dhe analiza të të dhënave.

FAZA 2

- Vizitat në shtëpi/klinikë.
- Ngarkimi elektronik dhe transferimi javor i të dhënave të spirometrive në Londër.
- Ngarkimi elektronik i përgjigjeve të pyetësorëve dhe transferimi në Londër.
- Ngarkimi elektronik dhe transferimi i plotë i të dhënave në Londër.
- Analizë “cross-site” e të dhënave nga pikat e implementimit të BOLD-it.
- Publikimi i punimit.
- Paraqitja e të dhënave për sponsorët, në takimet 6 mujore të sponsorëve, të zhvilluara së bashku me takimet e ATS dhe ERS.
- Shpërndarja e rezultateve të BOLD-it, përmes prezantimeve formale dhe jo formale.

Ky studim është aktivitet pan-evropian me përfitim pan-evropian.

PROCESI I PËRKTHIMIT TË PYETËSORËVE

Ky proces synonte të përkthente pyetësorët, nga gjuha origjinale në të cilën ato u zhvilluan, (anglisht) në gjuhën shqipe, duke siguruar ekuivalencën konceptuale.

Ky proces përbëhej nga 5 hapa:

Hapi 1. Përkthimi fillimisht nga anglishtja në gjuhën shqipe

U realizua duke i konsideruar të gjithë pyetësorët si një e tërë, duke siguruar kështu konsistencën dhe integritetin brenda dhe ndërmjet pyetësorëve.

Një person lokal dygjuhësh, i çertifikuar, u rekrutua për përkthimin e dokumenteve burimore, duke prodhuar kështu një version të parë të pyetësorëve (i quajtur Versioni i Përkthyer 1). Një raport u dërgua në Qendrën Operacionale, duke përshkruar problemet e interpretimit, të cilat çuan në modifikimet përkatëse pasuese.

Hapi 2. Përkthimi nga shqipja në gjuhën angleze

Një person tjetër lokal, dygjuhësh, i çertifikuar, i cili nuk kishte kontakt me dokumentet burimore, u rekrutua dhe përktheu dokumentet e Versionit 1, nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, duke prodhuar kështu një version të dytë të pyetësorëve (i quajtur Versioni i Përkthyer 2). Versioni i përkthyer 2, u dërgua në Qendrën Operacionale.

Hapi 3. Krahasimi i përbashkët i përkthimit 1 dhe 2 nga Qendra Operacionale

Keqkuptimet, përkthimet e gabuara dhe pasaktësitë, në Versionin e Përkthyer 1, u identifikuan dhe u diskutuan me Qendrën Operacionale. Ndryshimet e bëra në këtë version, prodhuan Versionin e Përkthyer 2, në gjuhën shqipe.

Hapi 4. Testimi i pacientit

Versioni i Përkthyer 2, në gjuhën shqipe, u testua në një panel prej 5 pacientësh shqiptarë me SPOK. Ky test ishte një kontroll i fundit, për të siguruar që Versioni i Përkthyer 2, ishte qartësisht i kuptueshëm, për folësit vendas. Ai u krye përmes intervistimeve direkt, ku intervistuesit pyetën të intervistuarit, nëse kishin ndonjë vështirësi në të kuptuar, mënyrën se si ata e kuptonin një pikë specifike, delikate dhe sugjerimet e propozuara nga pacientët e intervistuar, në lidhje me këtë. E gjithë kjo u pasqyrua në raportin dërguar Qendrës Operacionale, duke përfshirë të dhëna në lidhje me numrin e pacientëve të intervistuar, gjininë, moshën dhe kohën mesatare për të plotësuar të gjithë pyetësorët. Ky proces, prodhoi Versionin e Përkthyer 3, në gjuhën shqipe.

Hapi 5. Miratimi përfundimtar i përkthimeve në gjuhën shqipe

Versioni i Përkthyer 3, në gjuhën shqipe, u aprovua nga Qendra Operacionale, e cila na dërgoi versionin PDF të të gjithë dokumentit. Ky dokument, nuk mund të modifikohet pa aprovim. Të gjithë pyetësorët u ngarkuan në faqen e internetit të BOLD-it. Ne ishim të lirë t'i kopjonim dhe t'i përdorim ato.

PRINTIMI I 8 PYETËSORËVE PËR PËRDORIM PËR PUNËN NË TERREN

Çdo pyetësor përfshin informacionin si më poshtë:

1. Pyetësori i BOLD-it i të Dhënave Minimale, i Pranimit ose i Refuzimit

Përfshin informacionin në lidhje me demografinë, simptomat dhe çrregullimet respiratore, sëmundjet bashkëshoqëruese dhe pirjen e duhanit.

2. Pyetësori i BOLD-it i Spirometrisë

Përfshin informacionin në lidhje me çështjet e sigurisë; ndonjë infeksion respirator në 3 javët e fundit; ndonjë medikament të marrë për të lehtësuar frymëmarrjen; cigaren e fundit të pirë; matje antropometrike; rezultatin e spirometrisë; komplikacione të lidhura me testin e spirometrisë, të vëzhguara nga teknikieni.

3. Pyetësori Thelbësor i BOLD-it

Përfshin informacionin në lidhje me demografinë, arsimimin, sendet në pronësi të familjes në kohën e tashme dhe të kaluar; simptomat dhe çrregullimet respiratore (kollë, sputum, wheezing/whistling, dispne) dhe gravitetin e tyre, vizitat te mjeku për probleme të frymëmarrjes, medikamentet e marra për problemet respiratore dhe/ose çdo aktivitet lehtësues i kryer; statusi i pirjes së duhanit, duke përfshirë çdo substancë tjetër lokale rekreative të tymosur, përpjekjet për lënien e duhanit, duhanpirjen ambientale (familje, vendi i punës, mjediset shoqërore dhe gjatë); KAP; ekspozimin në punë; sëmundjet bashkëshoqëruese shtesë; pyetësorin QoL; ndikimin ekonomik (ditët e humbura të punës).

4. Pyetësori i BOLD-it i Biomassës dhe i Karburantit

Përfshin informacionin rreth mjeteve kryesore të gatimit (zjarr i hapur me qymyr; koks; dru; mbetje të korrave ose bajga; vajguri); ngrohjes së shtëpisë ose ujit (zjarr i hapur me qymyr; koks; dru; mbetje të korrave ose bajga) në të kaluarën (për më shumë se 6 muaj në jetën e tyre) dhe kohën e tashme; procesit të ventilimit (oxhak; ventilator; dritare/dyer të hapura); karburantit të përdorur rregullisht për të gatuar ushqim në shtëpi; vendit në shtëpi; efekteve të ekspozimit; mënyrës dhe kohëzgjatjes së ngrohjes së shtëpisë.

5. Pyetësori i BOLD-it i Pirësve të Cigareve

Përfshin informacionin në lidhje me varësinë nga nikotina (pyetësori Fagerstrom), llojet specifike të cigareve të tymosura; sasinë e tyre; shpenzimet e lidhura me cigaren; markën e përdorur më së shumti; vendin e blerjes; me filter ose pafiltër; informacionin e përmbajtjes së katranit; vendet ku i intervistuari ishte i lejuar të pinte duhan; ekspozimin ndaj çdo promovimi lidhur me cigaret, në 30 ditët e fundit.

6. Pyetësori i BOLD-it i Profesionit

Përfshin informacionin në lidhje me profesionin: (ka punuar ndonjëherë për ≥ 3 muaj); masat mbrojtëse të aplikuara; gjendjen aktuale të punësimit;

informacionin në lidhje me profesionin ose punën, që individi kishte ushtruar për kohën më të gjatë; pozicionin hierarkik; kodin e tij ISCO; çfarëdo problemi respirator të lidhur me punën që e detyroi individin të linte punën.

7. Pyetësi i BOLD-it i Frekuencës së Ushqimit

Përfshin informacionin në lidhje me konsumin mesatar, të sasisë së specifikuar të ushqimeve, të ngrëna në 12 muajt e fundit, si më poshtë vijon: bukë dhe role; drithëra mëngjesi; bollgur; makarona (dhe ushqime me prejardhje gruri); produkte buke/ëmbëlsira; oriz; sheqer dhe reçel; produkte sheqeri; çokollatë; vajra bimorë; margarinë dhe lipide me origjinë të përzier; gjalpë dhe yndyrna shtazore; arrorë; bishtajore; perime; rrënjë niseshteje ose patate; fruta; lëngje frutash; pije jo-alkoolike dhe alkoolike; mish i kuq dhe produktet e mishit; shpezët; të përbrendëshmet; peshku dhe prodhimet e detit; vezët; qumështi (i lopës) dhe soja; djathrat; produkte të tjera të qumështit; ushqime të ndryshme.

Informacione shtesë u morën në lidhje me produktet për përdorim të veçantë ushqimor, alergjitë ose intolerancën e lidhur me ushqimin, nëse ndiqej ndonjë dietë e veçantë, sëmundjet e lidhura me metabolizmin.

8. Pyetësi i BOLD-it i Gjurmimit të Pjesëmarrësit

Përfshin informacione në lidhje me të dhënat demografike, të dhënat e mbledhura, arsyet e mospërgjigjes, identifikuesit e grupeve.

Rekrutimi i stafit që punoi në terren

U rekrutuan 8 mjekë, të ndarë në 4 grupe pune, të përbërë secili nga një teknikien dhe një intervistues. Bazuar në rekomandimet e dhëna nga Qendra Operacionale, për secilin prej tyre u caktua një kod unik me 4 shifra, për identifikim specifik të mëtejshëm. I gjithë ekipi u trajnuar nga trajnerë, tashmë të trajnuar nga ekipi BOLD-it në Londër.

Objektivat e trajnimit

- Intervistimi në terren.
- Plotësimi i pyetësorëve.
- Ngarkimi elektronik i të dhënave në faqen web të BOLD-it.
- Matjet antropometrike.
- Kryerja e spirometrisë, kalibrimi i spirometrave.
- Aplikimi i Ventolinës.
- Lidhja e spirometrit me kompjuterin dhe ngarkimi elektronik i testeve të spirometrive.

Figura 4 dhe 5. Trajnimet dhe aparatet e spirometrisë të përdorura në studim.

Figura 4



Figura 5



NDD EasyOne™

STUDIMI PILOT

I gjithë informacioni i marrë deri në atë kohë, u përdor për zbatimin e punës në terren. Të dhënat kishin lidhje me:

- Kohën mesatare të vizitës në terren, të deduktuar gjatë testimit të pacientëve me SPOK.
- Koordinimin dhe bashkëpunimin midis teknikienit dhe intervistuesit.
- Çështjet lidhur me përzgjedhjen e zonave administrative për punën në terren.
- Planifikimin e vizitave në terren, përfshirë të gjitha përgatitjet dhe pajisjet e nevojshme.

PUNA NË TERREN

- Caktimi i kodit unik 6 shifror.
- Marrja e aprovimeve me shkrim nga pjesëmarrësit, për të gjitha aspektet e studimit. Ata që nuk ishin të gatshëm të jepnin aprovimin, konsideroheshin të papërshtatshëm.
- Administrimi i pyetësorëve duke filluar me pyetësorin Minimaldhe atë të Spirometrisë (për çështje sigurie, përpara fillimit të testimit të spirometrisë). Më tej plotësohej pyetësori Thelbësor dhe të gjithë të tjerët.
- Matjet antropometrike
- Spirometri para dhe pas Ventolinës, sipas protokollit të BOLD-it: të paktën 15 min pas aplikimit të 200 mcg Salbutamol (2 shkrepje x100 mcg).
- Vlerësimet e kohës totale, të nevojshme mesatarisht, për të përfunduar të gjithë procesin në terren dhe variacionet e saj.

Menaxhimi i kohës ishte elementi kryesor dhe gjatë intervistimit u ndoqën rregullat e paracaktuara, si më poshtë vijojnë:

- Privatësia për të dhënat e çdo pjesëmarrësi dhe komoditeti maksimal.
- Pyetjet u lexuan siç ishin shkruar.
- Nuk u bë asnjë sugjerim, ose interpretim gjatë leximit.
- Nuk u lejua asnjë befasi ose mimikë, ndërsa dëgjoheshin përgjigjet e të intervistuarve.
- Pyetjet u përsëritën, kur pjesëmarrësit nuk i kuptonin ato.
- Fjalët me shkronja të theksuara, ose të nënvizuara, u perifrazuan më fort.

Grupet e punës ishin të pajisur me Spirometër nndEasyOne™; peshore dixhitale për matjen e peshës; metër; spireta rezervë; inhalatorë me Salbutamol; kapëse të hundës; kartopeceta; alkool; oksimetra; volumatikë (GSK) plus formularët e konsentit dhe të gjithë pyetësorët.

TË DHËNAT PËRKATËSE TË STUDIMIT PILOT

- U testuan 40 pjesëmarrës: 20 burra dhe 20 gra.
- Çdo pjesëmarrës u kodua me një ID unike: nga 999001 në 999040, sipas udhëzimeve BOLD-it
- Lidhje unike identitare midis testit të spirometrisë dhe pyetësorëve, për çdo pjesëmarrës.
- Konfigurimi i spirometrave nndEasyOne™, sipas parakushtit të BOLD-it (NHANES III).
- Kontrollimi çdo ditë i kalibrimit të spirometrit nndEasyOne™.

Pyetësorët u plotësuan sipas një plani të paracaktuar: fillimisht pyetësori Minimal, pastaj ai i Spirometrisë (për të kontrolluar çështjet e sigurisë), pyetësori Thelbësor dhe të gjithë të tjerët më pas.

Për të shmangur ngjarjet e padëshiruara të lidhura me spirometrinë, procedura u krye në pozicion ulur dhe u aplikuan vetëm dy shkrepje të Salbutamol.

Testi post-BD, u krye të paktën 15 min, pasi u realizuan të paktën 3 manovra të pranueshme dhe 2 të përsëritshme për spirometrinë pre-BD. Teste të pranueshme, u konsideruan ato me një cilësi A, B dhe nganjëherë C. Një mësim i madh i nxjerrë gjatë kësaj faze, në bashkëpunim me Qendrën Operacionale, ishte se asnjë spirometri nuk duhej fshirë, pavarësisht cilësisë së saj.

Puna në terren eci paralelisht me ngarkimin elektronik, sistematik, të testeve të spirometrive dhe përgjigjeve të pyetësorëve, në faqen e internetit të BOLD-it, e cila ishte e mbrojtur me fjalëkalim. Kodet në lidhje me medikamentet respiratore ISCO 88 dhe markat e cigareve, u ngarkuan elektronikisht, në përputhje me udhëzimet e BOLD-it.

Çdo teknikien u vlerësua dhe u çertifikua sipas cilësisë së spirometrisë, bazuar në pikëzimin e FVC, FEV₁ dhe fluksit. Teknikieni u çertifikua, nëse 2 nga këto 3 parametra u vlerësuan ≥ 3 , për 10 grupe spirometrike të ngarkuara elektronikisht. Në rast të përgjigjes "jo i çertifikuar", teknikieni duhej të kryente dhe të ngarkonte elektronikisht një seri tjetër, prej 10 testesh spirometrike.

Ky system i pikëzimit, mundësoi mbikëqyrje të vazhdueshme të cilësisë.

Pas përfundimit të studimit pilot, u dërgua një raport i shkurtër në Qendrën Operacionale, me të dhëna në lidhje me pjesëmarrësit, vizitat në terren, problemet e hasura dhe zgjidhjet e sugjeruara. Këto ishin çështje për t'u diskutuar me Qendrën Operacionale. Kjo mundësoi identifikimin e problemeve të mundshme në të ardhmen dhe zgjidhjet e tyre, përpara fillimit të fazes së dytë, atë të zbatimit të studimit.

Rezultatet e studimit pilot, nuk u përfshinë në të dhënat përfundimtare.

PËRZGJEDHJA DHE REKRUTIMI I POPULLSISË SË STUDIMIT

BOLD-i u ideua kryesisht, si një studim i prevalencës së SPOK-ut, tek adultët jo-të institucionalizuar, të moshës ≥ 40 vjeç. Përsa i përket secilit vend, qëllimi ishte që të mblidheshin të dhëna lidhur me spirometrinë dhe pyetësorët, për minimumi 300 meshkuj dhe femra jo-të institucionalizuar të moshës ≥ 40 vjeç, bazuar në kriteret BOLD-it:

- Përfaqësueshmëria e popullatës target: zona e përzgjedhur duhet të ketë një popullsi totale të të gjitha moshave, të paktën 150,000 njerëz.
- Zbatimi i kampionimit rastësor, të shtresëzuar të mostrave.
- Procesi i kampionimit u hartua nga një ekspert lokal dhe u aprovua nga Qendra Operacionale, Londër.

Duke marrë parasysh përvojën e mëparshme të studimit të BOLD-it, me një shkallë përgjigjeje prej 80% dhe një shkallë të spirometrive të papranueshme prej 15%, madhësia e mostrës u dizenjua për të përfshirë 1200 pjesëmarrës, duke përjashtuar të rriturit e institucionalizuar.

Duke marrë parasysh përvojën e mëparshme të BOLD-it, me një shkallë përgjigjeje prej 80% dhe një shkallë të spirometrive të papranueshme prej 15%, madhësia e mostrës u dizenjua për të përfshirë 1200 pjesëmarrës, duke përjashtuar të rriturit e institucionalizuar.

Individët në studimin tonë u zgjedhën rastësisht, por sipas një përqsajeje sistematike, duke arritur vetëm ato që ishin të lehtë për t'u gjetur. Ekzistonin dy arsye, që kjo qasje të merrej në konsideratë. Arsyeja e parë lidhej me faktin se një e treta e popullsisë shqiptare, ishin emigrantë jashtë vendit, pavarësisht nga fakti që ishin të regjistruar te mjeku i familjes (ose në regjistrin kombëtar). Arsyeja e dytë, lidhej me faktin se një pjesë e të rriturve, qëndronin me fëmijët, ose të afërmit e tyre, jashtë vendit, për një pjesë të mirë të vitit. Ne u bazuam te regjistrat e mjekut të familjes. Fillimisht identifikua rastësisht, familjet në regjistrat dhe më pas infermierja, ose mjeku i familjes, njoftoi anëtarin e familjes për datën dhe vendin e vizitës. Më pas, konsideruam vetëm ata anëtarë të familjes, që u gjetën në shtëpi në kohën e njoftimit, të cilët ranë dakord për kryerjen e vizitës. Në këtë mënyrë, planifikuam arritjen e objektivit prej 1200 personash.

Procesi i “clustering” u krye sipas mënyrës së kampionimit, të parashikuar në Planin e BOLD-it. Ky plan u aplikua nga një ekspert epidemiolog vendas, duke përdorur të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë në Shqipëri për vitin 2004.

Sipas këtij regjistrimi, popullsia e përgjithshme në Shqipëri ishte 3,194,417 banorë, e organizuar në 12 prefektura.

Procesi i përzgjedhjes së mostrave përfshiu stratifikimin, si më poshtë vijon:

Shtresa 1- zgjedhje e rastësishme e 3 prefekturave, nga 12 në total.

Prefekturat e zgjedhura ishin: Tirana, Lezha dhe Vlora. Secilës prej tyre iu caktua një kod unik, në dakordësi me Qendrën Operacionale. si më poshtë vijon:

- Tirana - kodi 10 (355 10 0001- 10 0810)
- Lezha - kodi 11 + 12 (355 11 001-355 11 0152, 355 12 001 - 355 12 0018)
- Vlora - kodi 13 (355 13 001- 355 13 0220)

Popullsia e tyre totale është renditur, si më poshtë vijon:

- Tirana - 745.027 njerëz; popullsia \geq 40 vjeç është 272,571
- Lezha - 159,881 njerëz; popullsia \geq 40 vjeç është 58,514
- Vlora - 202,295 njerëz; popullsia \geq 40 vjeç është 74,018

Tabela 4. Popullsia sipas prefekturave të përzgjedhura.

Prefektura	Popullata totale	Popullata 40+	Popullata në studim
Tirana	745,027	272,571	810
Lezha	159,881	58,514	170
Vlora	202,295	74,018	220
Total	1,107,203	450,103	1200

Tabela 5. Ndarja urbane dhe rurale e popullsisë së prefekturave të përzgjedhura.

Prefektura	Urban		Rural		Total
	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër	
Tirana	74,722	75,192	61,135	61,522	272,571
Lezha	15,458	16,724	12,648	13,684	58,514
Vlora	19,910	20,800	16,290	17,018	74,018
Total	110,090	112,716	90,073	92,224	450,103

Shtresa 2 – zgjedhja rastësore e adultëve ≥ 40 vjeç, nga 3 prefekturat e zgjedhura tashmë. Ata u substratifikuan sipas gjinisë së tyre dhe urban/rural, si më poshtë vijon:

Nënshtresat

- 1 = mashkull urban
- 2 = femër urbane
- 3 = mashkull rural
- 4 = femër rurale

Në Tiranë u zgjodhën rastësisht 810 persona:

- urban = 526 (263 meshkuj; 263 femra)
- rural = 284 (142 meshkuj; 142 femra)

Në Lezhë u zgjodhën rastësisht 170 persona:

- urban = 102 (51 meshkuj; 51 femra)
- rural = 68 (34 meshkuj; 34 femra)

Në Vlorë u zgjodhën rastësisht 220 persona:

- urban = 144 (72 meshkuj; 72 femra)
- rural = 76 (38 meshkuj; 38 femra)

PUNA NË TERREN

Filloi në fillim të Tetorit 2012. Pjesëmarrësit u kontaktuan përmes telefonit, në bashkëpunim të ngushtë me mjekët përkatës të familjes. Ky bashkëpunim, vazhdoi gjatë gjithë procesit.

Figura 6. Proçedura e kryerjes së spirometrisë në terren.



Gjatë zbatimit të procesit, u vunë re disa fenomene. Këto u diskutuan në tryezat e rumbullakëta, gjatë gjithë procesit dhe u trajtuan sipas rastit:

- Disa pjesëmarrës u ndjenë të lodhur gjatë pretestit dhe në disa raste ata refuzuan të vazhdonin me teste të mëtejshme.
- Disa pjesëmarrës nuk e kuptuan siç duhet manovrën e FVC, pavarësisht përpjekjeve të shpjegimit të vazhdueshëm.
- Disa pjesëmarrës nuk ishin të gatshëm të kryenin testin e spirometrisë.
- Disa pjesëmarrës refuzuan inhalimin e Ventolinës, për shkak të bindjeve të tyre se ky medikament përdoret për pacientët astmatikë dhe ata i druhashin përdorimit, pavarësisht nga shpjegimi i kryer.
- Disa pjesëmarrës ndjeheshin të lodhur gjatë plotësimit të pyetësorëve.

Puna në terren filloi së pari në Tiranë. Vlora dhe Lezha ishin prefekturat e radhës.

Spirometritë dhe ngarkimi elektronik i pyetësorëve, u bënë në mënyrë sistematike, me frekuencë në varësi të intensitetit të punës në terren. Kontrolli i spirometrive u bë nga Qendra Operacionale, me “feed-back” përkatës, duke ndikuar në manovrat e mëtejshme të testimit.

I gjithë procesi i intervistimit, kryerjes së testeve spirometrike dhe ngarkimit të të dhënave për 1200 pjesëmarrës, përfundoi në Shtator 2013. Gjatë kësaj kohe, pati një bashkëpunim shumë të ngushtë me Qendrën Operacionale, në varësi të vështirësive të hasura, përfshirë problemet e “software ndd”. Disa herë u përdorën “Skype” dhe “Team Viewer” dhe u kontaktua edhe “Ndd Medizintechnik” AG Zürich, sipas rekomandimit të Qendrës Operacionale. Ky bashkëpunim i ndërsjelltë, ndihmoi në mbarëvajtjen e të gjithë procesit.

REZULTATET

Nga 1200 adultë të ftuar për të marrë pjesë në studim, 997 (83%) prej tyre plotësonin kriteret për të qenë pjesë e studimit. Midis tyre, 11 (0.009%) pjesëmarrës u përjashtuan për shkak të të dhënave jo të plota të spirometrisë dhe për shkak të mos kryerjes siç duhet të spirometrisë. 47 (0.039%) pjesëmarrës të tjerë, u përjashtuan për shkak të spirometrisë së papranueshme post-BD.

Tabela 6. Rezultatet.

Rezultatet	Meshkuj	Femra	Të panjohur	Total
<u>Pjesëmarrësit që u përgjigjën:</u>				
Të dhëna të plota të mbledhura (pyetësi Thelbësor plus spirometri të pranueshme post-BD sipas kontrollit të cilësisë)	467	472	0	939
Të dhëna të plota të mbledhura (pyetësi Thelbësor plus spirometri të papranueshme post-BD sipas kontrollit të cilësisë)	27	20	0	47
Të dhëna të plota të mbledhura (humbje e të dhënave të spirometrisë për shkak të problemeve me spirometrin) ¹	2	9	0	11
Totali i pjesëmarrësve që u përgjigjën	496	501	0	997
<u>Pjesëmarrësit që nuk u përgjigjën:</u>				
Të dhëna të pjesëshme të mbledhura	51	49	0	100
Refuzuar (Të dhëna minimale të mbledhura)	2	2	0	4
Refuzuar (as të dhëna minimale të mbledhura)	43	32	0	75
Kishin lënë zonën përkohësisht	3	10	0	13
Të paarrtshëm (nuk u mund të arriheshin) ²	4	5	0	9
Total i pjesëmarrësve që nuk u përgjigjën	103	98	0	201
<u>Të papërzgjedhshëm:</u>				
Vdekur	1	1	0	2
Kishin lënë zonën në mënyrë të përhershme	0	0	0	0
Të papërzgjedhshëm për shkak të moshës	0	0	0	0
Të institucionalizuar	0	0	0	0
Të pagjurmueshëm (adresë dhe telefon i gabuar) ³	0	0	0	0
Total i të papërzgjedhshmëve	1	1	0	2
Total i personave të rekrutuar⁴	600	600	0	1200

1. Disa të dhëna të spirometrisë humbën para se të transferoheshin, për shkak të një defekti të spirometrit

2. Informacioni i kontaktit, në dukje i saktë, por asnjë përgjigje gjatë kontaktimit

3. Informacioni i kontaktit i pasaktë, informacion i përditësuar jo disponibël

4. Numri i pjesëmarrësve që u përgjigjën + pjesëmarrësve që nuk u përgjigjën + atyre të papërzgjedhshëm

Tabela 7. Shkalla e përgjigjes¹ për Shqipërinë.

	Moshë				Total
	40-49 vjeç	50-59 vjeç	60-69 vjeç	70+ vjeç	
Metoda A²					
total					82.2% (1200)
Metoda B³					
total					82.3% (1198)
Metoda C⁴					
mashkull	84% (187)	84% (166)	81% (144)	85% (95)	83% (592)
femër	84% (230)	88% (218)	83% (90)	72% (46)	84% (584)
total	84% (417)	86% (384)	82% (234)	81% (141)	84% (1176)

1. Pjesëmarrësit që u përgjigjën, janë ata që kompletuan spirometrinë post-BD (pavarësisht nga rezultatet e Kontrollit të Cilësisë) dhe pyetësorin Thelbësor.
2. Emëruesi (në kllapa) përfshin këdo që implementuesi u përpoq të kontaktojë.
3. Emëruesi (në kllapa) i limituar për pjesëmarrësit që u përgjigjën dhe që nuk u përgjigjën.
4. Emëruesi (në kllapa) i limituar për të gjitha subjektet që kanë një formular gjurmimi (përfshin pjesëmarrësit që u përgjigjën dhe që nuk u përgjigjën me: të dhëna të pjesshme të mbledhura; refuzuar (të dhëna minimale të mbledhura) dhe refuzuar (as të dhëna minimale të mbledhura) si në Tabelën 1.

Në tabelën 7, vihet re se shkalla e përgjigjes së personave të seleksionuar për të marrë pjesë në studim, është mjaft e lartë, pavarësisht metodës së përdorur për të vlerësuar përgjigjen e tyre.

Tabela 8. Krahasimi i pjesëmarrësve që u përgjigjën¹ dhe atyre që nuk përgjigjën², për Shqipërinë.

		Pjesëmarrësit që u përgjigjën	Pjesëmarrësit që nuk u përgjigjën	P-value³
Mosha	40-49	351 (36%)	81 (40%)	0.382
	50-59	330 (33%)	55 (27%)	
	60-69	191 (19%)	40 (20%)	
	70+	114 (12%)	25 (12%)	
Gjinia	Mashkul ¹	494 (50%)	103 (51%)	0.768
	Femër	492 (50%)	98 (49%)	
Status i duhanpirjes	Aktual	213 (22%)	46 (23%)	<0.001
	Ex	148 (15%)	9 (4%)	
	Asnjëherë	625 (63%)	146 (73%)	
Asthma, emphysema, bronkit kronik ose SPOK-u i diagnostikuar nga një doktor⁴	Po	64 (6%)	6 (3%)	0.056
	Jo	922 (94%)	194 (97%)	
Co-morbiditete të tjera⁵	Po	260 (26%)	72 (36%)	0.007
	Jo	726 (4%)	129 (4%)	

1. Pjesëmarrësit që u përgjigjën, janë ata që kompletuan spirometrinë post-BD (pavarësisht nga rezultatet e Kontrollit të Cilësisë) dhe pyetësorin Thelbësor.

2. Pjesëmarrësit që nuk u përgjigjën, janë individë të përzgjedhshëm të cilëve u mungon pyetësori Thelbësor dhe/ose spirometria post-BD, por për të cilët dihet "tabulated variable".

3. Two-sided p-value, bazuar në testin Pearson chi-square.

4. Për pyetjen 3 mbi pyetësorin e të dhënave Minimale, për personat që nuk u përgjigjën. Pyetja 12, 13, 14, 15 në pyetësorin Thelbësor për pjesëmarrësit që u përgjigjën.

5. Për pyetjen 4 në pyetësorin e të dhënave Minimale, për pjesëmarrësit që nuk u përgjigjën. Pyetja 26 në pyetësorin Thelbësor, për pjesëmarrësit që u përgjigjën.

Tabela 8, tregon se nuk ka dallime midis të anketuarve dhe atyre që nuk u përgjigjën, që janë të përshtatshëm për studim, përveç statusit të pirjes së duhanit dhe sëmundjeve të tjera bashkëshoqëruese (p-value < 0.001 dhe < 0.007 respektivisht). Pjesëmarrësit që janë duhanpirës aktualë dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese, kanë më pak të ngjarë të përgjigjen.

Tabela 9. Krahasimi i pjesëmarrësve që u përgjigjën¹, me dhe pa spirometri të përdorshme, për Shqipërinë.

		Me spirometri të përdorshme ²	Pa spirometri të përdorshme	P-value ³
Mosha	40-49	342 (36%)	9 (19%)	0.047
	50-59	314 (33%)	16 (34%)	
	60-69	178 (19%)	13 (28%)	
	70+	105 (11%)	9 (19%)	
Gjinia	Mashkull	467 (50%)	27 (57%)	0.302
	Femër	472 (50%)	20 (43%)	
Statusi i duhanpirjes	Aktual	206 (22%)	7 (15%)	0.403
	Ex	142 (15%)	6 (13%)	
	Asnjëherë	591 (63%)	34 (72%)	
Asthma e diagnostikuar nga një Doktor⁴	Po	55 (6%)	1 (2%)	0.281
	Jo	884 (94%)	46 (98%)	
SPOK-u i diagnostikuar nga një Doktor⁵	Po	3 (0.3%)	0	0.689
	Jo	936 (99.7%)	47 (100%)	
Sëmundje zemre e diagnostikuar nga një doktor⁶	Po	38 (4%)	1 (2%)	0.51
	Jo	901 (96%)	46 (98%)	

1. Pjesëmarrësit që u përgjigjën, janë ata që plotësuan spirometrinë post-BD (pavarësisht nga rezultatet e Kontrollit të Cilësisë) dhe pyetësorin Thelbësor.

2. Spirometri e përdorshme, e përkufizuar si pikëzim i cilësisë post-BD > 1 për secilin FEV₁ dhe FVC

3. Two-sided p-value bazuar në testin Pearson chi-square. SHËNIM: Në disa raste, numrat janë shumë të vegjël për analiza domethënëse statistikore.

4. Për pyetjen 13 në pyetësorin Thelbësor.

5. Për pyetjen 15 në pyetësorin Thelbësor.

6. Për pyetjen 26A në pyetësorin Thelbësor.

Nga tabela 9, vihet re se vetëm moshë është një faktor i rëndësishëm për përgjigjen e pranueshme në raport me gjininë, statusin e pirjes së duhanit, apo sëmundjet bashkëshoqëruese (Asthma, SPOK-u, apo sëmundje zemre të diagnostikuara nga një doktor).

Tabela 10. Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë, së pjesëmarrësve që u përgjigjen¹, për Shqipërinë.

Sexi	Moshë				Total
	40-49	50-59	60-69	70+	
Mashkull	158	139	116	81	494
Femër	193	191	75	33	492
Total	351	330	191	114	986

1. Pjesëmarrësit që u përgjigjen, janë ata që kanë të dhënat e pyetësorit Thelbësor dhe spirometri post-BD me rezultat të çfarëdoshëm.

Tabela 10, jep një panoramë të përgjithshme të shpërndarjes sipas grupmoshave dhe gjinisë të personave që u konsideruan të vlefshëm për studimin.

Tabela 11. Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë, së pjesëmarrësve që u përgjigjen¹, me spirometri të përdorshme, për Shqipërinë.

Sexi	Moshë				Total
	40-49	50-59	60-69	70+	
Mashkull	155	131	107	74	467
Femër	187	183	71	31	472
Total	342	314	178	105	939

1. Pjesëmarrësit që u përgjigjen, janë ata që kanë të dhënat e pyetësorit Thelbësor dhe spirometri post-BD me rezultate të cilësisë > 1 për secilin FEV₁ dhe FVC.

Tabela 11, tregon shpërndarjen sipas moshës dhe gjinisë, në lidhje me realizimin e kryerjes cilësore të spirometrisë për t'u konsideruar e vlefshme. Vihet re se 47 pjesëmarrës nuk konsiderohen të përzgjedhshëm për studim, sepse nuk kanë realizuar kryerjen e spirometrisë siç kërkohet nga standardet e BOLD-it.

Tabela 12. Shpërndarja e popullsisë, sipas moshës dhe gjinisë, për Shqipërinë.

		Mosha				Total
		40-49	50-59	60-69	70+	
Aktual¹	Mashkull	17.7%	14.6%	9.5%	7.6%	49.3%
	Femër	18.1%	14.1%	9.6%	8.9%	50.7%
	Total	35.9%	28.7%	19.1%	16.3%	100.0%
E vlerësuar²	Mashkull	17.7%	14.6%	9.5%	7.5%	49.3%
	Femër	18.1%	14.1%	9.6%	8.9%	50.7%
	Total	35.9%	28.7%	19.1%	16.3%	100.0%

1. Të dhënat aktuale për çdo vend për krahasim.

2. Vlerësimi i ponderuar “Weighted estimate” bazuar në të dhënat e pjesëmarrësve që u përgjigjën. Meqenëse vlerësimet janë pashtresuar sipas grupmoshës dhe seksit, duke përdorur ndarjen aktuale të popullsisë, të dy grupet e numrave do të bien dakord.

Tabela 12, pasqyron shpërndarjen sipas gjinisë dhe grup moshës të pjesëmarrësve në studim. Vihet re që kjo shpërndarje aktuale, është e përputhshme me pjesëmarrjen e vlerësuar, duke treguar përlllogaritje të sakta statistikore të përcaktimit të mostrës për studim.

Tabela 13. Prevalenca e duhanpirjes aktuale, sipas moshës dhe seksit, për Shqipërinë.

		Mosha				Total
Seksi		40-49	50-59	60-69	70+	
Pjesëmarrës që u përgjigjën me të dhëna të përdorshme¹	Mashkull	40.5%	44.6%	29.3%	21.0%	35.8%
	Femër	7.8%	8.4%	5.3%	3.0%	7.3%
	Total	22.5%	23.6%	19.9%	15.8%	21.6%
Popullata²	Mashkull	44.5%	46.7%	29.4%	21.1%	38.7%
		(5.2)	(1.7)	(5.6)	(7.8)	(3.2)
	Femër	6.5%	8.3%	4.8%	5.2%	6.5%
	(3.2)	(1.8)	(4.2)	(4.5)	(0.9)	
Total	25.3%	27.9%	17.1%	12.4%	22.4%	
	(3.2)	(1.0)	(4.4)	(4.0)	(1.8)	

1. “Non-weighted data” për mostrën e pjesëmarrësve që u përgjigjën.

2. Vlerësimi i ponderuar i popullsisë (weighted population estimate), me SE të treguar në kllapa.

Tabela 13, tregon prevalencën e pirjes së duhanit në Shqipëri. Vihet re që ajo është relativisht e lartë, 21.6% e pjesëmarrësve, me predominim të shprehur të meshkujve në raport me femrat, në përqindjet respektive 35.8% dhe 7.3%.

